

# Florë

Viti 1 • Numri 2 • Prill-Qershor 2013

Lulet  
e Diellit...



ARGJENDARI

"Liliano"

ARGJENDARI

ITALIANE  
RUMBULLOJME  
AR

TE PERDORUA  
RIPAROJME  
DHE PASTROJME  
SENDE ARI

ARGJENDARI  
"LILIANO"



Adresa: Tek Dollari, Shkodër - Shqipëri  
Cel: +355 69 20 45 115



Fëmijët janë si lulet... Kanë nevojë për dashuri, durim dhe sakrifica. Çdo lule është e veçantë, e ndryshme nga të tjerat. Disa e duan ujin shumë, disa e duan diellin shumë, disa të tjera rriten në të gjitha kushtet; por kanë një të përbashkët: të gjitha lulet rriten me dashuri, zbukurohen nga dashuria. Fëmijët gjithashtu, janë të ndryshëm. Disa janë çapkënë, disa janë të qetë, disa janë nevrinë, disa të tjerë janë të dhembshur... Disa fëmijë duan që t'u kushtohet vëmendje, kurse disa të tjerë zemërohen nga kujdesi i tepërt; prandaj duhet të kemi kujdes të sillemi sipas rastit. Një shprehje e urtë thotë:

"Nëse mendoni për vitin e ardhshëm, mbillni një farë; nëse mendoni për dhjetë vjet më vonë, mbillni një fidan. Nëse mendoni për shekujt që do të vijnë, edukoni fëmijët."

Ashtu siç lulja i drejtohet diellit, ashtu edhe fëmija drejtohet nga njeriu që do. Njeriu që e gjen dashurinë brenda familjes, nuk ka nevojë ta kërkojë atë diku tjetër. Mes fëmijës dhe prindërve duhet të krijohet një dashuri e tillë, që fëmija të ketë frikë të bëjë gabime që mund ta shuajnë këtë dashuri. Në këtë mënyrë, puna e prindërve bëhet më e lehtë, sepse fëmija diskuton çdo problem me ta dhe merr çdo vendim, duke u bazuar në mendimet e tyre.

Ka rëndësi të tregojmë respekt ndaj mendimeve të fëmijëve, sepse edhe ato kanë rëndësinë e tyre dhe nuk është e thënë që gjithmonë të kenë të njëjtat mendime me ne. Nuk duhet të sillemi me fëmijët sikur të ishin një pronë e jona, një plaçkë. Duhet t'u japim edhe atyre mundësinë për t'u dhënë përgjigje negative kërkesave tona. Nëse nuk veprojmë në këtë mënyrë, fëmija mësohet të japë vetëm përgjigje pozitive dhe ndihet i detyruar të pranojë çdo gjë, të mirë e të keqe.

Gjëja më e rëndësishme për fëmijët tanë është morali i tyre. Ne duhet t'i edukojmë ata me edukatën islame. Duhet t'u mësojmë fëmijëve tanë arsyen që na ka sjellë në këtë botë dhe cili duhet të jetë qëllimi ynë në jetë. Fëmija që jeton në përputhje me rregullat e Zotit, është i lumtur në këtë botë dhe në botën e përtejme.

**BOTUESI**  
Shtëpia Botuese "Progresi"

**DREJTOR & KRYERADAKTOR**  
Alban Kali

**REDAKTOR**  
Brikena Smajli

**KORREKTOR**  
Zija Vukaj

**PËRKTHYES**  
Erinda Kraja | Eva Kajti  
Naile Sulaj | Verzana Nikshiqi

**DIZAJN**  
Bledar Xama

**ADRESA**  
L: Vasil Shanto; Rr: Çajupi  
Shkodër; Shqipëri

**MOBILE**  
+355 67 208 6767

**E-MAIL**  
revistaetika@progresibotime.com

# Përmbajtja



**Ushqyerja  
në periudhën e fëmijërisë** 34  
*Betyl Nefise Inall*



**Delikatesa në të folur** 20  
*Osman Nuri Topbash*



**Burri është  
i bukur në namaz** 14  
*Neslihan Nur Turk*

**Fëmijën nuk e  
edukojnë vetëm  
prindërit!..** 24  
*Melike Shakin*

**Brenga  
e një gruaje  
të devotshme** 12  
*Tuba Sökmen*

**Të drejtat e  
fëmijëve në Islam** 26  
*Halime Demireshik*

**Familja një shkollë  
adhurimi** 5  
*Tuba Çenar*

**Nefsi Mylheme** 17  
*Ajshenur Vurall*

**Si dielli, që ngroh  
dhe ndriçon** 30  
*Kubra Çoban*

**Zjarri i imoralitetit** 7  
*Rukije Gjengly*

**Mosmarrëveshje  
të pazgjidhshme?!** 18  
*Shefika Kaja Meric*

**Ajo që fitohet  
nga i zoti i shtëpisë  
i mjafton familjes** 32  
*Fatma Baan*

**Kufijtë mes  
dy gjinive** 10  
*Fatma Nur Xhahan*

**Gdhendie  
si në mermer** 23  
*Zahide Topçu*

**Bakllavaja** 36  
*Rushan Kavallë*





# Familja

## një shkollë adhurimi

Allahu e krijoi njeriun që të adhurohej prej tij. Çdo gjë që njeriu përjeton gjatë jetës: gëzimet, shqetësimet dhe marrëdhënia me njerëzit përreth, duhet të formohen duke kaluar nga filtri e adhurimit. Të paktën, këtë pret Islami nga pa-suesit e tij.

Kur e vështrojmë jetën nga ky aspekt, vërejmë se edhe “institucioni i familjes” brenda të cilit njeriu lind, rritet dhe, pas një kohe, e formon dhe e drejton vetë një të tillë, duhet të realizohet brenda kornizës së adhurimit e nënshtrimit ndaj Zotit.

Njeriu, edukatën fetare, në fillim e merr nga prindërit, pra nga familja. Si rezultat i këtij edukimi, ashtu siç bëhet e qartë në hadithet fisnike, një numër i madh njerëzish e kalojnë jetën duke ndjekur “fenë e prindërve të tyre”.

### Faza e formimi të vatrës familjare

“Bazat e adhurimit” zënë një vend vërtet të rëndësishëm te gratë dhe burrat, që rriten dhe formojnë vetë familje. Të dy palët bëjnë zgjedhjet e tyre sipas përpjekjes dhe sinqeritetit në adhurim. Vetëm familjet që formohen me këtë këndvështrim, tregojnë kujdes ndaj saktësive fetare, ashtu siç duhet.

Nëse, kur formojnë familjen, njerëzit nuk zgjedhin jetesën sipas fesë, por bëjnë më shumë zgjedhjen e mallit, pasurisë, reputacionit, bukurisë dhe gjëra të tjera, që mund të ndryshojnë në çdo çast të jetës, do të thotë se vatra e tyre ka filluar të ndërtohet mbi një terren të rrëshqitshëm.

Siç duhet të zgjidhen në fillim bazat fetare në jetën individuale, edhe kur formohet familja, gjatë fejesës dhe martesës, duhet të merren parasysh po



këto baza. Një familje e shëndoshë realizohet në një mënyrë jetese larg luksit, zbukurimeve, mburrjes. Sinqeriteti dhe modestia do t'i japin martesës një jetë më të gjatë dhe më me shumë begati.

### Faza pas formimit të vatrës familjare

Feja islame ia bën të ditur, të drejtat dhe përgjegjësitë (me të gjitha detajet), të dyja palëve. Siç dihet komunikimi i gruas me bashkëshortin, me të afërmit dhe fëmijët brenda dhe jashtë shtëpisë, po ashtu dihet edhe se burri nuk përjashtohet nga përgjegjësitë e tij. Nëse të dyja palët e kanë të qartë dhe e respektojnë në masën e duhur autoritetin dhe përgjegjësinë që ka secili, familja do të vazhdojë të jetë e shëndetshme dhe e qetë.

Burri është i detyruar ta kërkojë lumturinë në familje dhe po aty ta formojë sërish atë. E gjithë përgjegjësia materiale e shtëpisë është kryesisht mbi supet e tij. Sigurimi i mirëqenies së familjes në masën e nevojshme dhe hallall, është detyra më thelbësore e tij. Përveç kësaj, ai duhet ta trajtojë bashkëshortin me dashuri, respekt, mëshirë dhe me ndjenja sakrifice. Ai duhet ta dijë gjithashtu se bashkëshortja dhe fëmijët te ai janë **"Amaneti i Allahut"**. Për këtë çështje duhet të marrë shembull nga jeta e përkryer e Pejgamberit, **sallallahu alejhi ve sellem**, dhe sjellja e tij ndaj bashkëshorteve, fëmijëve dhe nipërve.

Edhe gruaja, pas martesës, duhet të jetë e kujdesshme dhe të sakrifikojë për të respektuar të drejtat e bashkëshortit dhe të fëmijëve. Ajo duhet ta pranojë veten si nënë, si bashkëshorte dhe si njeri më i respektuar i familjes, rezultati i të cilit duhet patjetër të rrezatojë **"dashuri dhe respekt"**.

Në shoqërinë ku jetojmë, ka një sërë të drejt-

tash dhe detyrimesh që i ngarkohen familjes dhe bashkëshortëve. Një pjesë e këtyre të drejtave dhe detyrave janë zakonet që kanë mbetur nga shoqëritë e kohës së **xhahililijetit** (injurancës). Ato ndajnë role të ndryshme për burrin dhe gruan dhe, nganjëherë, mund t'i ngarkojnë vetëm njëres anë përgjegjësi të rënda dhe të pa-justifikueshme.

Kështu, përgjegjësia që kanë burri mysliman dhe gruaja myslimane është dhënia përparësi, respektimit të këshillave të fesë, sado e rëndë qoftë trysnia e zakoneve dhe e traditave pagane apo sado që ata të jenë nën kërcënimin e përjashtimit nga shoqëria.

Tipari që duhet t'i paraprijë një besimtari, është dashuria ndaj Allahut dhe kujdesi që ai tregojë ndaj urdhrave dhe ndalesave që Ai ka vënë. Nëse pranimin apo refuzimin e njerëzve kemi filluar ta vlerësojmë më shumë se kënaqësinë dhe zemërimin e Allahut (xh.sh.), do të thotë se duhet ta rivlerësojmë edhe njëherë vetëdijen e të qenit rob vetëm i Allahut Teala. Siç thotë edhe Rabiati'l-Adevijje:

"Nëse Allahu është i kënaqur prej meje, nuk ka aspak rëndësi urrejtja e të gjithë njerëzve!..Por nëse kam bërë diçka që e ka zemëruar Allahun, kjo është një fatkeqësi e madhe, edhe nëse të gjithë njerëzit janë të kënaqur me këtë!.."

Atëherë, martesë duhet të jetë një shkollë që përforcon te njeriu adhurimin ndaj Allahut. Përndërit, të cilët mundohen t'i japin hakun secilit prej pjesëtarëve të familjes dhe që respektojnë bazat e fesë, e kthejnë familjen në parajsë në këtë botë dhe në tjetrën.

Siç e theksuam edhe në fillim, çdo rast me të cilin jeta i përball njerëzit, është një sprovë më vete. Kështu, disa njerëz mund të sprovohen duke u martuar, disa të tjerë, edhe pse duan të martohen, duke mos u martuar. Prandaj, ne na takon të jetojmë me kushtet e jetës që Allahu ka vlerësuar për ne, në mënyrë që të fitojmë kënaqësinë e Tij dhe, në fund, ta kalojmë në mënyrën më të bukur **"sprovën e adhurimit"**.

Allahu qoftë mbështetësi dhe ndihmëtar i ynë më i madh për të fituar kënaqësinë e Tij në be-tejën e vëshirë të jetës! Amin!





*Rukije Gënyly*

# ZJARRI I IMORALITETIT



Allahu i Madhëruar, pasi krijoi Ademin nga hiçi, krijoi për të një zonjë, tek e cila do të gjente qetësinë dhe e bëri atë bashkëshorte të tij. Allahu i Madhëruar ka përcaktuar që shtimi i njerëzimit të fillojë prej tyre, prandaj dhe u ka dhënë atyre disa të drejta dhe përgjegjësi dhe i ka urdhëruar që të jetojnë në bazë të natyrës njerëzore (natyrshmërisë së krijimit).

Martesa në Islam, nuk është ndërtuar në bazë të një interesi ose dëshire kalimtare. Kjo fole e ndërtuar mbi dashurinë dhe respektin, që rrjedhin nga mirëkuptimi dhe matura e ndërsjelltë, sjell në jetë krijesën më të shquar të botës, "njeriun", të cilit ia plotëson kërkesat dhe e përgatit për të kryer detyrat e shenjta që ka ndaj shoqërisë. Kështu, familja formon njësinë më të vogël, por më të domosdoshme të shoqërisë. Çdo element që mund ta tronditë atë (marrëdhënia jashtëmartesore, shpifja..etj.) është e ndaluar në fenë islame dhe për t'i parandaluar ato janë marrë masa shumë të rrepta.

Feja jonë e bukur, Islami, para se të ndalojë ndonjë sjellje që e dëmton njeriun, më përpara i mbyll të gjitha rrugët që të çojnë te ajo sjellje, duke e vështirësuar kryerjen e saj e kjo është shprehje e mëshirës së Allahut të Madhërishëm.

Për shembull, para se të shpallej ajeti i nderuar që ndalon zinanë (marrëdhënien intime jashtëmartesore) është urdhëruar lidhja e kurorës dhe janë inkurajuar njerëzit për këtë. Në këtë mënyrë, është lehtësuar plotësimi i kësaj nevoje njerëzore në rrugë të ligjshme (të lejuar).

*Kurorë* do të thotë marrje nën mbrojtje e të drejtave të burrit dhe të gruas; do të thotë të mos lejohet që gruaja të përdoret për një dëshirë kalimtare e pastaj të hidhet tutje. Në këtë mënyrë, në sajë të kurorës, është ndaluar shfrytëzimi i gruas nga ana fizike dhe shpirtërore. Edhe burri me anë të folezës familjare e ndalon egon e tij dhe orientimin për pushtet dhe mbrojtje, e shfrytëzon për gruan dhe fëmijët e tij. Ai mundohet t'i mbrojtë ata nga problemet dhe fatkeqësitë e jashtme. Në këtë mënyrë, të dy palët jetojnë në një klimë mbrojtjeje dhe qetësie.

Nga ana tjetër kurora është një element i rëndësishëm që mbron nderin, dëlirësinë dhe respektin e shoqërisë. Është pothuajse si një rufepritës që mbron brezat. Për këtë arsye, në hadithin e nderuar thuhet: *"O ju të rinj! Kush ka mundësi prej jush, le të martohet menjëherë. Sepse martesa është një kështjellë e qëndrueshme që e mbron më së miri syrin dhe nderin tuaj nga harami. Kurse kush nuk ka mundësi të martohet, le të agjërojë; sepse agjërimi e thyen*

*epshin.*" (Buhariu, Kurora, 2-3; Muslimi, Kurora, 1)

Për të mos rënë në kurthin e zinasë, së pari Islami ka nxitur për martesë, së dyti ka ndaluar qëndrimin në një vend, vetëm për vetëm, të një burri dhe një gruaje, që mund të martohen mes tyre. Në hadithin e nderuar thuhet: *"Një burrë dhe një grua le të mos qëndrojnë vetëm, përndryshe shejtani bëhet i treti mes tyre."*

Në një hadith tjetër theksohet: *"Shejtani rrjedh ndër damarët e njeriut, duke pritur rastin për ta shtyrë atë të bëjë gjynah."* (Buhariu, Itikaf, 11; Muslimi, Selam, 23)

Kështu që, nuk është parë e përshtatshme që një njeri, beqar apo i martuar, të rrijë vetëm për vetëm me persona të huaj, përveç atyre me të cilët Allahu ua ka ndaluar martesën përjetësisht (nëna, motra, babai, vëllai etj.) Ky ndalim nuk ndryshon as në rastin e të afërmeve brenda familjes, si: kunata, kunati etj. Le të theksojmë një fakt: ndalimi i përmendur, është për qëndrimin në një vend të vetmuar, të njerëzve që mund të martohen mes tyre, pra në një vend ku nuk hyjnë e dalin njerëz. Brenda familjes, kur, për shembull, është i pranishëm burri, vëllai, babai ose ndonjë e afërme tjetër e gruas, nuk është problem që, brenda normave të lejuara, të rrijë me të afërmit meshkuj ose t'i qerasë ata. Në këto raste, është kusht që të bëjë kujdes me veshjen dhe mënyrën se si lëviz... Sepse, në qoftë se femra shkëput çdo lidhje me kushërinjtë më të afërm dhe sillet me ta si të ishin të huaj, mund të shkaktojë trazira të tjera në familje. Ajo, ashtu siç shëtit, blen dhe flet në pazar brenda kufijve të lejuar, ashtu dhe me kushërinjtë më të afërm duhet të ulet, të flasë dhe t'u shërbejë brenda normave që kërkon lidhja familjare. Veç nuk duhet ta lejojë që kjo gjendje të kthehet në një gjendje të shturur dhe të palejuar.

Islami, ndërkohë që ka ndaluar marrëdhënien jashtëmartesore, ka mbyllur dhe një rrugë tjetër që të çon tek ajo, me *mbulesën*. Mbulesa është rregulluar në përputhje me natyrën e femrës dhe mashkullit. Meqë trupi i femrës është i tëri një zbukurim më vete, është urdhëruar të mbulohet në përputhje me këtë fakt, kurse për mashkullin, për hir të dëlirësisë dhe nderit, është e nevojshme të ruajë shikimet e tij. Në ajetin e nderuar thuhet: ***"Thuaju besimtarëve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluara) dhe ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)! Kjo është më mirë për ta!*** (Surja En-Nur, 30)

Por është e pakuptimtë të presësh mbrojtje (mbulesë) vetëm nga femra. Të dy gjinitë janë të detyruar të mbrojnë nderin dhe dëlirësinë e tyre. Sepse të



parit të çon në të folur dhe të folurit në të afruar. Prandaj Islami, e ka kufizuar qysh në fillim problemin, duke pasur për qëllim mbrojtjen e emrit të mirë dhe të dinjitetit të shoqërisë.

Ruajtja e shikimeve është mbrojtja e zemrës, sepse syri është çelësi i zemrës. Për këtë arsye, Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Mos ia shtoni shikimin shikimit. I pari është prej jush, të tjerët janë prej shejtanit.”* (Tirmidhiu, Edep, 28; Ebu Davud, Nikah, 44)

Të gjitha organet mund të ndërmjetësojnë për zina, por meqë syri udhëheq në këtë rast, mbrojtja e syrit nga harami është shumë e rëndësishme.

Siç është kërkuar nga meshkujt që të mbrojnë shikimet e tyre edhe prej femrave është kërkuar e njëjta gjë në këtë ajet të nderuar: **“Thuaju besimtareve që të ulin shikimet e tyre (nga e ndaluar), ta ruajnë nderin e tyre (nga marrëdhëniet e jashtëligjshme)”** (Surja En-Nur, 31)

Në këtë ajet, në të njëjtën mënyrë është kërkuar nga zonjat të mbrojnë shikimin (syrin), i cili është dera e parë e marrëdhënieve jashtëmartesore. Kjo do të thotë se nuk mjafton që femra thjesht të mbulohet, por edhe ta mbrojë syrin nga harami është po aq e rëndësishme sa mbulesa.

Ajeti vazhdon kështu: **“dhe të mos i shfaqin stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme... Dhe të mos i rrahin këmbët (për tokë), në mënyrë që të mos duken stolitë e tyre të fshehta.”** (të mos ecin në mënyrë që tërheq vëmendjen)

Kështu pra, është urdhëruar që gratë të mos ecin dhe as të sillen në mënyra të tilla që të shfaqin huret e tyre.

Edhe pse duke u nisur nga ky ajet, disa kanë thënë që gjërat e ndaluara në këtë ajet janë stolitë, si ‘vathët, byzylykët...etj’, në të vërtetë ‘stolitë’ e përmendura këtu janë pjesët ku janë vendosur ato, pra trupi i femrës. Siç është shprehur dhe më përpara ‘i gjithë trupi i femrës është një stoli më vete’. Por pjesët si fytyra, dora dhe këmba, që mbesin detyrimisht pa u mbuluar, bëjnë përjashtim. Disa medh-hebe të sakta kanë thënë që, meqë fytyra përmbledh të gjitha bukuritë e trupit, duhet mbuluar, por dijetarët e medh-hebit Hanefi kanë ndjekur rrugën e mesme dhe kanë pranuar që nuk është e nevojshme të mbulohet fytyra.

Në të vërtetë, shfaqja e ndaluar në ajet është shfaqja e gjërave, që i tregon femrat më të bukura se ç’janë. Për këtë arsye, nuk është e përshtatshme për gratë myslimane, t’i zbukurojnë fytyrat e tyre me makijazh dhe ashtu të dalin jashtë ne publik. Vendi i vetëm ku femrat duhet t’i shfaqin këto elemente që e zbukurojnë dhe e bëjnë më tërheqëse

atë, është shtëpia. Sigurisht që femrave u pëlqen të vishen e të zbukurohen, por shfaqja e këtyre bukuriave në vende jo të lejuara, mund të krijojë situata të papëlqyeshme për femrën, për bashkëbiseduesin dhe për të gjithë shoqërinë dhe përgjegjësja kryesore për këtë është vetë ajo.

E ndaluar në të gjitha fetë hyjnore, marrëdhënia jashtëmartesore është e ndaluar edhe në Islam me të gjitha format e saj. Bile për më tepër, çdo rrugë që të çon tek ajo është e ndaluar në fenë islame. Në Kuranin e Madhërisë, duke thënë, **“Dhe mos iu qasni kurvërisë, se ajo është shfrenim dhe rrugë e shëmtuar!”** (Surja El-Isra, 32), është theksuar që zinaja është shfrenim dhe rrugë e shëmtuar, për këtë arsye edhe është ndaluar prerazi, qoftë dhe afrimi ndaj saj. Sepse njeriu që i afrohet zinasë, nuk e ka të gjatë edhe rënien në kurthin e saj. Çdo hap i vogël, i parëndësishëm për njeriun i hap rrugë një gabimi të madh, të pariparueshëm. Zinaja është vetë më vete një zjarr. T’i afrosh zjarrit, shtohet rreziku i dëmtimit nga flakët dhe shkëndijat e tij.

Meshkujt, të cilët duan që zonjat e tyre të jenë të moralshme, duhet të jetojnë me nder dhe edukatë. Femrat, të cilat duan që burrat e tyre t’i shohin veç ato, duhet t’ua shfaqin bukuritë e tyre materiale dhe shpirtërore vetëm burrave të tyre.

Si përfundim, parimet e edukatës, turpfit dhe nderit nuk janë parime që duhet t’i kenë parasysh vetëm femrat ose vetëm meshkujt. Në qoftë se të dy gjinitë kryejnë si duhet detyrat që u bien përsipër, atëherë shoqëria do të jetojë në qetësi, lumturi dhe brenda kufijve të moralit. Kur kalohen këta kufij, tronditet rendi i shoqërisë dhe shkatërrohen familjet.

Zoti na mbroftë të gjithëve nga sherri i nefsit tonë, i cili urdhëron për të keqen dhe nga femrat e meshkujt që u janë bindur veseve dhe zakoneve të këqija të shejtanit... Amin!





# KUFIJTË MES DY GJINIVE

*Ihtilat* (takim, ndërlikim, ndikim) është termi fetar që do të thotë: qëndrimi në të njëjtin mjedis i një femre dhe mashkulli që nuk e kanë të ndaluar martesën me njëri-tjetrin. Pra, kjo çështje trajton problemin se sa afërsi mund të kenë dy njerëz të gjinive të ndryshme, të cilët nuk kanë lidhje gjaku apo qumështi. E thënë më shkurt, deri në cilin kufi duhet të jenë lidhjet mes dy gjinive në klasë, kafene, restorant apo në zyrë.

Të themi të drejtën, përgjigja e kësaj pyetjeje nuk është e lehtë. Së pari duhet të marrim parasysh mënyrën e jetesës në ditët e sotme dhe kushtet që ajo na dikton. Askush nuk na pyet se me kë kemi qejf të ndjekim shkollën fillore, nëntëvjeçaren, gjimnazin apo universitetin. As nënës dhe babait nuk i parashtrohen zgjedhje të përshtatshme, sipas dëshirave të tyre. Çdokush është i detyruar të zgjedhë alternativën më të përshtatshme mes atyreve ekzistuese. Për fat të keq, kjo “zgjedhje e përshtatshme” në të shumtën e rasteve është larg “ideales”.

Atëherë, prej ku duhet të fillojmë?

Që në shkollën fillore i pyesin me tendencë fëmijët tanë: “a ke shok?”, “a ke shoqe?” ... Këto janë pyetje të bëra me humor, por që ndikojnë në ndjenjat dhe mendimet e pastra të fëmijëve. Mendja e tyre, e pakultivuar, që nuk e dallon ndryshimin mes gjinive ose që nuk e ndjen nevojën të bëjë një diferencim të tillë, fillon të mendojë për këto çështje.

Një pikë kulmore e kësaj çështjeje (por që, për momentin, nuk është shumë e theksuar) është turpi që ndjen një vajzë apo një djalë, që fillon universitetin dhe që nuk ka pasur asnjë lidhje. Në mentalitetin “modernist” këta të rinj etiketohen si: “njerëz të shkretë që nuk i shikon askush” dhe që për të shpëtuar nga ky “turpërim i madh” fillojnë përpjekjet për të gjetur sa më shpejt një partner.

Për fat të keq edhe shoqëria jonë, mendimet tona dhe mënyra jonë e jetesës drejt asaj rruge po shkon. Nuk duhet të habitemi, nëse një ditë, shumë të afërt, do ta bëjmë tonin këtë stil jetese, sepse drejt asaj rruge jemi nisur krejtësisht.

Po jeta jashtë shkolle, në ç’gjendje është? Çfarë përhapin gazetatat, revistat, librat, kinemaja, muzika, televizioni? A nuk bëjnë përpjekje për t’i afruar artificialisht dy gjinitë?

Po kushtet në punë? Çfarë alternativash i serviren një gruaje apo burri që mbaron



shkollën dhe është në kërkim të një pune? Një grua besimtare dhe me mbulesë, a mund të gjejë një punë të përshtatshme? Po një burrë besimtar?

Tani e kemi më të qartë se, për t'iu përgjigjur pyetjes që parashtruam në fillim, duhet t'i kemi parasysh të gjitha këto rrethana.

Mbyllja e gruas në shtëpi është diçka që ka mbetur në shekujt e kaluar. Tashmë gratë (me të drejtë) kërkojnë të kenë jetën e tyre, të kenë të drejtën e tyre, të kenë të drejtën e fjalës... Në fakt, kjo është një e drejtë që grave u jepet edhe nga feja, por kur ajo ua jep këtë të drejtë, u tregon edhe kufijtë që nuk duhen kaluar. Gruaja duhet të ketë kujdes që të punojë në punë të përshtatshme, duhet të jetë e kujdesshme në veshje, duhet të jetë e ndershme, e matur dhe duhet të shmangë bisedat e kota me njerëzit që kanë mendime të papërshtatshme.

Të gjithë këto rregulla janë të vlefshme edhe për meshkujt. Ata duhet të kontrollojnë shikimin, gjuhën dhe edukatën e tyre.

Shkurtimisht, mund të themi se feja i vë disa kufij si gruas ashtu edhe burrit. Burrat nuk kanë të drejtë të sundojnë gratë, duke mos përfillur kufijtë e vendosur nga feja, por edhe gratë nuk kanë luksin e të priturit çdo gjë nga burrat. Secili duhet të jetojë ashtu siç ia dikton natyra e vet njerëzore dhe duhet të respektojë e t'u bindet rregullave të fesë.

Gruaja duhet të punojë në punë, të cilat nuk e detyrojnë që t'i lërë fëmijët e vet pa nënë. Edhe burri duhet të punojë në vende që janë të përshtatshme për natyrën e tij. Puna në vende të haramit (në kumar, në bare) është e ndaluar si për burrat ashtu edhe për gratë. Në të njëjtën kohë, harxhimi i parasë së fituar në gjëra të ndaluara është haram për të dyja gjinitë.

Le të vijmë në temën e qëndrimit në të njëjtin mjedis të grave dhe burrave...

Secila gjini duhet të qëndrojë, të punojë me grupin e vet; por, nëse janë të detyruar të kenë komunikim me njerëzit e gjinisë tjetër, besimtarët duhet të veprojnë në përshtatje me karakterin dhe personalitetin e vet të moralshëm e dinjitoz. Siç thuhet edhe në ajetet kuranore: duhet bërë përpjekje për të ruajtur shikimin. Në momentet kur besimtari është i detyruar të bisedojë me dikë të gjinisë tjetër, duhet të bëjë kujdes për moskapërcimin e kufijve. Një burrë dhe një grua nuk duhet të qëndrojnë vetëm në ambiente të mbyllura. Gratë duhet të jenë të kujdesshme në bisedat që bëjnë dhe të mos tregohen provokuese. Nuk duhen përdorur gjëra që mund të ngacmojnë mendime të këqija në mendjen e bashkëbiseduesit si: veshje të hapura, parfume me tepri apo veprime e biseda të tejzgjatura.

Për ta mbyllur, mund të themi se të dyja palët duhet të jenë të kujdesshëm, duke e ditur që zjarri me barutin nuk mund të qëndrojë pranë, sepse epshi shëtit në damarët e të dyve dhe u ngjall atyre dëshira e dyshime të papërshtatshme.

Uroj që Allahu të na ruajë nga çdo dyshim që mund të lindë nga egoja jonë.

Amin!





# Brenga e një gruaje të devotshme

*Tuba Sëkmen*

Duke u munduar të drejtohej në shtratin ku shtrihej i sëmurë, burri i moshuar ngriti duart e zbehta, që i dridheshin, nga qielli; bëri pendimin e fundit dhe falënderoi Allahun për sëmundjen.

Deri para disa muajsh i moshuari, përveç disa shqetësimeve të vogla shëndetësore, nuk ankohej nga ndonjë gjë tjetër. Jeta, të cilën e kishte zbukuruar me adhurime dhe vepra të mira për të fituar kënaqësinë e Allahut, ishte e mbushur me të gjitha mirësitë e Tij.

Gjithmonë thoshte se mes mirësive që kishte, më e shtrenjta ishte gruaja e tij e dashur. E kishin kaluar martesën e tyre me përpjekje të përbashkëta, duke i bërë dhuntitë e Zotit shkak për mirësi: ndonjëherë ishin bërë prindër për jetimët, ndonjëherë ishin kujdesur për të sëmurët, shkurtimisht në çdo derë që kishin shkuar, kishin kërkuar të shërbenin në rrugë të Allahut.

Ditët e bukura, të cilat kalonin në atmosferën e dëshirës për të arritur kënaqësinë e Allahut, ndryshuan papritur një ditë të enjte, kur burri i moshuar, i cili po falte namazin e iqindisë, theu kockën e këmbës. A e dinte se kjo ishte hera e fundit që ai po qëndronte në këmbë para Allahut?! Askush nuk mund ta dinte. Ai i priti me maturi dhe me falënderime njëra pas tjetrës, operacionin dhe të gjitha problemet shëndetësore, ashtu siç priste kohë më parë të gjitha mirësitë. Në ditët plot shqetësime ai gjente ngushëllim, kur zemrat thoshin: "Edhe kjo vjen nga Allahu."

Ngushëllimi më i madh për të



moshuarin në këto ditë të vështira ishte gruaja e tij e dashur, e cila nuk e la kurrë vetëm. Gruaja e moshuar, pa vënë re problemet e saj shëndetësore, me gjithë forcën që kishte, mundohej ta kalonte kohën duke i shërbyer bashkëshortit të saj nëpër spitale. Edhe pse doktori, infermieret dhe fëmijët mundoheshin ta kursenin, ajo nuk dëgjonte askënd.

I gjithë respekti dhe delikatesa që gruaja e moshuar tregonte për të gjithë, nga më i madhi e deri te më i vogli, pothuajse ishte mbledhur te bashkëshorti i saj. Ishte e pamundur të mos ndikohesh nga respekti, dashuria dhe interesi që kjo zonjë e nderuar tregonte ndaj burrit të vet. Burrit të moshuar i vinte të kapej pas xhaketës së vizitorëve e të ngrihej në këmbë, për t'i shprehur atyre mirënjohjen. Më shumë se ai vetë, ishte vepra e zonjës së tij të nderuar që ngjallte përreth tij këtë respekt dhe ndikim. Ishte ajo zonjë e devotshme që e kishte bërë burrin e moshuar vezir.

Martesa e tyre, afërsisht 65 vjeçare, nuk ishte nga martesat që tregohen në televizor apo lexohen nëpër libra, por ishte nga ato martesa të gjalla shembullore, që pasqyrojnë të drejtat e Islamit, përsosmëri, butësi dhe delikatesë. Askush gjatë gjithë jetës nuk kishte dëgjuar nga goja e gruas së moshuar ndonjë gabim të burrit; përkundrazi, sa herë që përmendte emrin e të shoqit, e kujtonte atë me respekt, dashuri dhe lutje. Gruaja e devotshme, për jetën e lumtur që kishte kaluar, së pari falënderonte Allahun, pastaj bashkëshortin e saj.

Shqetësimet dhe dhimbjet e të moshuarit qetësoheshin me bisedat dhe tregimet e saj të matura. Ajo i sugjeronte të bënte durim dhe zemra e tij zgjerohej me këndimin e sureve dhe lutjeve të saj.

Askush nuk mund ta dinte, nëse më prekëse për burrin e sëmure ishte vdekja, urdhri i Allahut për çastin e frymës së fundit apo lotët që bashkëshortja e tij derdhte e heshtur.

Gruaja e moshuar, duke fshirë lotët kërkoi sipër dollapit çantën e qefinit, të cilën kishte vite që e

kishte bërë gati, sikur çdo çast do të vdiste. Nxori nga çanta lidhëset prej pëlhure, që ishin përgatitur për të lidhur mjekrën dhe këmbët dhe ashtu siç kishte vepruar edhe kur ai ishte shëndosh, kreu me kujdes dhe delikatesë detyrën e fundit ndaj burrit të saj.

Kur erdhi makina e xhenazes, e cila do të çonte amanetin në udhëtimin e fundit, gruaja ishte ulur në gjunjë te koka e bashkëshortit dhe po i jepte ngadalë lamtumirën, gjë që asnjëri nga ata që ishin pranë nuk do ta harrojë kurrë.

Në atë kohë, kur të gjithë menduan se fjalët kishin mbaruar, ajo kishte akoma për të thënë:

“Zoti ta bëftë varrin kopsht prej kopshteve të xhenetit! Të kam shërbyer gjatë gjithë jetës sime me sa fuqi kam pasur dhe, nëse do ta kishe

jetën më të gjatë, përsëri do të të shërbeja me shumë dëshirë.

Tashmë do të të jem pranë vetëm me lutje. Unë jam e kënaqur nga ti, inshallah edhe ti je i kënaqur prej meje.”- tha duke iu dridhur zëri...

Kur shprehu dëshirën për t'u takuar me të në botën e përtejme, dukej sikur nga brenda dëshironte që kjo ndarje të mos zgjaste shumë.

Pastaj, ndërkohë që gruaja e moshuar i përsëriti në të dy veshët shokut të saj të jetës pyetjet që engjëjt e varrit do t'i bënin dhe përgjigjet, i derdeshin lotët që i ishin mbledhur në sy. Të pranishmit thoshin me vete: “Sa përcjellje e bukur!..”, ndërsa në fytyrën e ndritshme të burrit të moshuar kishte një shprehje sikur çdo çast do të zgjohej nga gjumi.

Punonjësit e morën trupin e të moshuarit që prehej në paqe dhe u larguan.

Pas asaj dite, gruaja e moshuar e kaloi të gjithë kohën me adhurim dhe vazhdoi t'u tregonte të gjithëve sjelljet shembullore të bashkëshortit të saj.

Ndërsa brengës së heshtur në sytë e zonjës së devotshme tashmë nuk i mungonte aspak buzëqeshja.





# BURRI është i bukur në namaz

*Për birin tim Omer Faruk...  
me dashuri, respekt dhe lutje...*

Sepse në namaz burri është krejt i pastër... Uji i abdesit, bashkë me të gjitha pjesët e trupit, ia lan edhe mendimin edhe qëllimin...

Në namaz burri është i mbuluar. Ai nuk mbulon vetëm trupin, por mbyll edhe sytë e zemrën ndaj gjërave të kësaj bote... Shikimin e mban ose tek majat e këmbëve, ose përpara te sexhdeja... është në çastet, kur i tërheq "sytë" nga çdo gjë dhe i kthen kah Allahu. Një madhështi bie mbi të.

Ju ndoshta mendoni se ia shihni të gjitha anët dhe se ia dini të gjitha të fshehtat. Por ai është si një aisberg që i duket vetëm 1/9... Pjesa tjetër është sekret, është mister. Ai është kthyer në një drejtim, në të cilin u kthye fillimisht më i bukur i burrave, Hazreti Pejgamberi, *sallallahu alejhi ve sellem*...

Kthimi nga Qabja pesë herë në ditë me vendosmëri dhe durim, është simboli i besnikërisë dhe sinqeritetit. Sa kohë që i zotëron këto cilësi, burri është i bukur.

Të jesh në namaz, do të thotë të jesh gati në kohë, në vendin e takimit, të jesh njeri me parime, i rreptë dhe i besueshëm, të bësh detyrën pa prekur sekonin. Çdo moment që gjendet në krye të sexhdes, burri bëhet edhe më i vyer... Burri që nuk shpërfill namazin, është ushtar i fjalës së dhënë: "Po, Ti

je Zoti jonë" ... Ngaqë qëllimi i tij është takimi me Allahun, dashuria, zjarri dhe dëshira marrin një ngjyrë krejt tjetër. Për çdo namaz që fal, vetëm me shpresën për të fituar kënaqësinë e të Dashurit, burri bëhet më i pjekur dhe më fytyrëndritur.

Burri është i bukur në namaz.

Sepse në namaz e pranon paaftësinë e tij... Ai trup trimëror përkul kokën në të djathtë dhe nuk mbetet vetëm me pranimin e vogëlsisë së tij, por sikur shuhet e ikën mes asgjësisë. Të shkrihet një burrë në sexhde, do të thotë që për çdo sexhde të gjejë një shpirt të ri. Ai i cili e dëshiron shumë të pëlqehet dhe të lartësohet, e arrin këtë me namaz, me vetëdijen se është Allahu Ai që me të vërtetë e meriton të lavdërohet dhe prej të Cilit vjen lartësimi. Sa herë që lidhet në namaz, burri lind sërish.

Shkon vetëtima që bubullon dhe në vend të saj vjen një re e brengosur, sytë e së cilës lotojnë... Sa bukur është o Zot, të qarët në heshtje të një burri në namaz! Madje, sa bukur është kur ai, me gjithë trimërinë e tij, qan me dënësë mes dëshpërimit dhe paaftësisë kundrejt Fuqisë absolute të Allahut!...

Po kaq i bukur është edhe qëndrimi i tij drejt, gjatë namazit. Sa mirë do të ishte sikur ky qëndrim të shpërndahej në të gjithë jetën e tij! Burri është



i bukur kur i del për zot amanetit, kur nuk hesht, por thërret me guxim kundrejt padrejtësisë dhe kur ndalon ligësinë e urdhëron për të mirë...

Ai që nuk di kijamin (qëndrimin në këmbë gjatë namazit), nga ta dijë qëndrimin drejt përballë jetës? Burri është trim, kur di të qëndrojë në këmbë dhe jo kur frikësohet e fshihet në një qoshe!.. Burri është burrë, kur nuk struket mënjane me veprim frikacak, nuk hesht, por vepron kundrejt paturpësisë dhe mosrespektit!

Kur ajetet kalojnë në gjuhën e tij, biseda me të Zotin, thellohet... Burri është i bukur, kur mbushet plot dashuri ndaj më të bukurës dhe nuk u jep rëndësi bukurive të tjera jashtë kornizës së hallallit.

Pa më thoni, kush ka parë të përkulet një mal? Por ja, rukuja e një burri i ngjan një mali që përkulet përpara Krijuesit. Burri është një mal i madh. Ka madhësi, karakter, paraqitje! Është një çinar madhështor, që u shton degë degëve dhe e forcon gjendjen e tij në namaz.

Si mund të krahasohet një burrë që e vë kokën në sexhde dhe ka arritur aty qetësinë e lumturinë, që i janë zbardhur flokët me zjarrin e dashurisë së vërtetë, që pendohet duke i ditur mangësitë dhe mëkatet e tij, me një burrë me prirje të çuditshme femërore, që heq qimet e kraharorit dhe të fytyrës...

Me çdo pikë loti që i rrokulliset në faqe, arrin përsosmërinë. Koka e tij në sexhde i ngjan hënës që vetëm lartësohet dhe diellit, që ngroh dhe ndriçon.

Burri është baba, vëlla, i dashur... Burri është i bukur në kërkim të riskut, në shërbim, në shtëpi, por sidomos kur bën uljen e fundit të namazit të natës... Çdo namaz është vetmim....E çdo vetmim është rrugëtim drejt së Vërtetës...

Kur sipas vendit tregon madhësi e bukuri dhe kur përgjërohet me zemër, duke ngritur duart nga qielli... Është i bukur kur turpërohet aty ku duhet, kur nuk mashtrohet nga fitneja, kur është fisnik dhe trim, guximtar dhe i qëndrueshëm...

Ai është burrë, kur e shpërndan selamin gjithandej, me buzëqeshje e modesti, kur të ardhmen e kthen në ngushëllim dhe mëshirë për të sotmen dhe të djeshmen...

Burri është i bukur në namaz.

Sepse në namaz është i dorëzuar, pra është musliman! Në qetësi nuk ngel sekret dhe fshehtësi. Në atë çast fytyra i skuqet si një vajze të turpshme

dhe thotë "Estagfirullah". Ja, burri është i bukur në ato çaste, kur pastrohet nga harresa, "balta" dhe indiferenca.

Jo! Burri nuk është i bukur, kur rregullon flokët e mjekrën në parukeri, kur mban veten me veshje e zbukurime, kur blen jahte e shtëpi, por kur drejtohet nga burimi i mirësisë dhe e ndan bujarisht për hir të Allahut me falënderimin ndaj Tij.

Burri është trim, kur i shpreh Allahut të fshehtat dhe shqetësimet, që nuk ia ka thënë askujt, kur ia qan hallin e vet Atij dhe kur e mban mbi supë shqetësimin e tij të fuqishëm me vendosmëri dhe në një mënyrë që i ka hije vetëm burrave. Ai është i vyer kur nuk ikën nga vështirësia dhe nuk e hedh *mahrem*in e tij. Është burrë, kur mbushet me mëshirë dhe është i vetëdijshëm dhe kur përpara Zulejhavë gjendet i ftohtë dhe i ndershëm.

Burri është i bukur kur e fiton pasurinë e tij me djersën e ballit dhe pastërtinë e trupit, pa ia hedhur madje as sytë ryshfetit që i vihet mbi tavolinë; kur nuk vjedh dhe kur arrin ta mbrojë brezin e tij edhe nga dëmi i një kafshate haram.

Kur ka një mendje të urtë dhe një ndjenjë të thellë, është i veçantë. Ndërsa, kur shëtit jo vetëm në tokë, por edhe në "qiell", atëherë është i zgjedhur. Me këto fjalë nuk dua të flas për shkuarjen në Hënë apo në Mars. E kam fjalën për Arshin, për afrimin të Zotëruesi i Arshit. Burri është burrë kur adhuron vetëm Allahun dhe madje, vetëm me madhësitinë e tij ndal mizorin dhe mizorinë! Jo!.. Mashështia nuk bëhet me bukuri, por me besim!..Jo!.. Fuqia nuk bëhet me krahë e me muskuj, por me besim!.. Fisnikëria nuk bëhet me faresis, por me ruajtjen e nderit!..

Nga njëra anë burri është fëmijë, i pastër, i qartë dhe i ndjeshëm, sepse është foshnjë nënë, nip gjyshi, nxënës i një mësuesi. Ai është qarku i hënës së plotë, kalaja e qyteteve, mbrojtësi i jetimëve dhe zëri i memecëve. Burri është i bukur kur thotë "O Zot!", kur mëshiron, kur rrudh vetullën dhe kur i qeshin sytë. Ai është i bukur kur brendësinë e dinjitetit të tij e zbukuron brenga dhe me një shikim të vetëm, fal gëzim.

Në fakt, nuk ka asnjë kohë që ai nuk e mbush me mirësi... Burri është i bukur kur edhe në ëndërr flet për hallet e njerëzve, kur ulet në sofra të pasura dhe ngrihet duke u ngopur me një pjatë supë dhe kur bëhet lumë mirësish për të tjerët! Ai është i bukur, kur hyn në shtëpi dhe nuk grindet, kur nuk i poshtëron dhe nuk tallet qoftë edhe me më të afërmit e

tij dhe kur nuk mendon për ligësi e mashtrime.

Atëherë o djalë, dëgjoji mirë këto që do të them:

Nganjëherë është një entuziazëm që vjen e ikën. Mos e quaj dashuri çdo gjë që të tërheq. Gjëja më prekëse te burrat është barku, sepse më së shumti ai tregon grykësi, dembelizëm dhe sëmundje. Ha pak djalosh. Ha pak që të të udhëheqë urtësia dhe madhështia.

Pse nuk të mjaftojnë lodrat që të blihen? Shiko sa bukur, ke kukulla, makinë dhe shtëpi. Shko luaj me to dhe mos ia vër syrin asaj që nuk të takon. Ndiq atë që sakrifikon edhe veten për të të mbrojtur ty dhe ik nga ai që e kalon kufirin dhe të ngjitet për këmishë! Ka nga ata që janë dhe s'janë në jetën tënde, që vijnë e ikin si një imazh... Nëse nuk mund të marrësh çdo gjë që dëshiron, nëse nuk mund të bësh çfarë dëshiron, mos harro se kjo është bota!.. Në fakt, edhe ti si të gjithë fëmijët je vetëm rrugëtues i xhenetit, por ja që nuk ka xhenet në të dy botët, mos harro...

Nëse ke besuar, rregulli është i qartë: Mos e zgjat dorën te harami. Ky rregull nganjëherë do ta vësh-tirësojë nefsin tënd. Por ti përsëri luaje me dashuri dhe entuziazëm rolin që i ka hije një besimtari. Ësh-të çudi që nganjëherë, të vënë përpara kafshatën haram, në momentet kur je më i uritur...

Atëherë supozo që po luajnë me ty, se po masin sinqeritetin tënd. Supozo se je në një provë. Mundohu ta fitosh atë! Nëse ti nuk mendon të fitosh kënaqësinë e Allahut, gëlltite atë pa turp në stomak. Por nëse ti je nga ata që kërkojnë dashurinë e Allahut edhe sikur të vdesësh nga uria, mos e ha, nuk mund ta hash! Dije mirë se nuk ka shërim nga harami. Nga harami nuk shpresohet mirësi. Prandaj, jo me dorë dhe me gjuhë, por mos e prek atë as me cepin e syrit.

Lumturinë e gjen në shtëpi djalosh! Mos e kënaq

fitnen, e cila do të të çojë në humbje. Largohu nga ajo sa të kesh mundësi. Mos u mashtro nga ndjenja e ëmbël që ajo të fal. Mbështetju Allahut, që të mos gabosh. Ajo që ke përballë nganjëherë është helm me veshje mjalti, nganjëherë zjarr me pamje uji... A nuk e ke dëgjuar atë që lajmëroi në emër të atij kurthi:

“Nëse syri të kap gjithçka, ngrije perden nga ajo dhe shiko Allahun. Ne jemi fitne dhe të mashtrojmë.”

Sidomos kur sytë e tu ngelin të ngulitur te perdet. Nëse ndjen se akoma nuk ke arritur “të shohësh” Allahun, atëherë bëhu më i zgjuar, do të thotë se je akoma i dobët. Por përsëri je trim. A e di se çfarë ka dashur të thotë ai që tha se një e nënta e trimërisë është shmangia? Mendo djalosh! Ajo që të bën trim është largimi (shmangia) nga harami. A të mbetet burrëri, nëse bie në haram duke u bërë rob i dëshirave dhe kurban i pasioneve?

Syve të tu të bukur u ka hije shikimi i qartë! Duarve dhe këmbëve, u ka hije mirësia. Atëherë mos ia vësh-tirëso vetes gjërat! Mos shëtit me këmbëngulje në anë të greminës. Mos dil nga streha jote e ngrohtë e të hidhesh në një vorbull, e cila do të të shkaktojë humbje. Thonë se nuk ka zgjidhje për atë që do të ndodhë dhe për atë që do të vdesë, por ti përsëri, sa të mundesh, bëhu i zgjuar djalosh!

Kokës tënde në sexhde dhe qafës tënde të bukur i ka hije një qëndrim madhështor. Forcës dhe dashurisë tënde i ka hije takimi me Allahun!..Ty të ka hije të shkosh me fytyrë të bardhë, me shikim te maja e këmbëve, me besimin në majë të kështjellës... Prandaj, mos e konsidero namazin një ritual me pesë kohë të limituara në ditë... Kur është nevoja qëndro në namaz në çdo kohë, edhe pa e dëgjuar ezanin!.. Vishe mburojën në çdo kohë dhe jo vetëm për namaz. Shko tani, merr abdest dhe, pash Allahun, mos e harro këtë të varfër në lutjen tënde...





# Nefsi Mylheme

*"Nganjëherë fluturoj mbi re  
dhe vështroj botën nga lart,*

*Nganjëherë zbres në tokë  
dhe bota më vështron mua."*

(Nesimi)

Ah sa e mjerë është egoja!..

Ajo shkon drejt pushtimit të majave si një feniks, por e gjen veten të mbyllur në një kafaz, si një papagall me pendë të rëna... Ëndrrat ta kanë prerë rrugën, ëndrrat besnike... Ëndrra me njerëz dhe me ngjarje, ëndrra me të shkuarën e me të ardhmen, ëndrra të mbushura me të fshehta... Shenjat janë krejt të qarta. Telepatitë, istiharet dhe interpretimet e ëndrrave...

Kjo është si një perde...e njerëzit nuk e kuptojnë!

Përputhjet e rastit janë shumë të ëmbla për nefsin mylheme... Sa bukur është kur në çdo hap që hedh, pushton një zemër; që kur bën një dhuratë, e kupton se ajo është diçka shumë e pëlqyer nga ai që e merr... Kur zgjat rrugën e kthimit vetëm për të ndihmuar një grua të moshuar në mbajtjen e trastave... Kur je duke folur para njerëzve dhe e kupton se po shpjegon atë që ata kanë më shumë nevojë të dëgjojnë... Njerëzit të falënderojnë dhe të lavdërojnë aq shumë, sa egoja jote dehet nga kënaqësia...

Është e çmendura e kësaj bote, por ajo nuk e di!

Duatë e atij njeriu pranohen; çdo gjë që ajo do, realizohet. Asgjë nuk është e ëmbël për të sa ndjenja e të qenit e afërt me Allahun, të qenit pranë Tij... Nuk janë të ëmbla, as ëndrrat e bukura e as mashtrimet e vogla...

Kur i bën dua të sëmurit, ai shërohet. Kur lutet për dikë që ka probleme, problemet zgjidhen si me magji. Kur bën dua për të kërkuar bollëk, hapen dyer prej aty nga nuk

pritej. Këto veti e bëjnë atë të çmohet, dalëngadalë ajo merr një vend të veçantë në rrethin e saj shoqëror.

Kur është vetëm, ajo shijon ajrin e pastër; gjatë netëve, ajo shihet në pasqyrën e vetes... Nganjëherë, i duket sikur është duke parë Atë që nuk mund të shihet...

Tashmë, asaj kjo botë i duket e vogël!

Asaj i pëlqen të mendojë:

"Ka një vit që çdo natë ngrihem dhe fal namazin e natës."

"Ka pesë vjet që nuk kam lënë pa falë asnjë namaz të sabahut."

"Nuk mund të fle asnjë ditë, pa lexuar Kuran. Nuk më zë gjumi, pa lexuar Librin e Allahut."

"Nuk është mirë të ulesh në sofër, pa mysafirë, ata i sjellin gjallëri shtëpisë."

"Nuk kam lënë asnjë namaz për më vonë."

Papritur kandilat shuhen, dritat ulen! Ditë pas dite namazet nuk falen më, namazet e natës harrohen, mysafirët bëhen një gjë e bezdisshme. Kurani nuk hapet më.

Oh, këto ditë të ndarjes që vijnë pas një bashkimi të mrekullueshëm!

Në fillim nuk e merr seriozisht dhe thua se do të kalojë, mendon që do ta marrësh veten për një kohë shumë të shkurtër.

Por nuk ndodh ashtu... Kjo periudhë është shumë e gjatë dhe ti fillon ta quash veten hipokrite ... këtë gjë ia thua vetëm vetes në fshehtësi...

Sa e rëndë është ta humbësh qetësinë e shpirtit! Si mund të ecë përsëri në rrugën e drejtë ai njeri që humb ekuilibrin?

Ajo tashmë hallakatet në botë, pa krahë për të fluturuar!..

Sa keq për këtë që i ndodh nefsit mylheme!.. Ngjitesh me aq vështirësi e, për një çast, të rëshqet këmba dhe rrokullisesh krejt poshtë! Fiton aq shumë gjëra me mundim dhe pastaj i humb e, të gjitha bëhen hi! Sa e dhimbshme është të shkatërrohen të gjitha ëndrrat para syve dhe të mos jesh në gjendje të bësh asgjë. Edhe njëherë mbytesh në përpjekje të pafrytshme...dhe fillon gjithmonë nga e para...

Je e dëshpëruar në këtë botë të madhe...



*Sbefika Kaja Meriç*

# MOSMARRËVESHJE TË PAZGJIDHSHME!

Allahu e ka krijuar njeriun prej një gruaje dhe një burri. Hz. Ademi dhe Hz. Havaja janë njerëzit e parë të krijuar prej Tij, ata janë gjithashtu edhe të parët në çdo gjë që kanë bërë.

Martesa është një nga nevojat e natyrshme të njerëzve, në të njëjtën kohë, ajo është dhe rruga e domosdoshme për mbijetesën e njerëzimit dhe ka lindur bashkë me krijimin e Havasë dhe Ademit, prej të cilëve janë shtuar brezat njerëzorë.

Dashuria që lindi mes tyre është një ndjenjë, që Allahu (xh.sh.), ua ka dhënë njerëzve, e domosdoshme kjo, për krijimin e familjes dhe vazhdimësinë e brezave. Martesa është një institucion që pranohet si i domosdoshëm nga të gjitha fetë hyjnore dhe nga vetë logjika e njerëzore.

Çdo njeri i martuar ka pak a shumë njohuri rreth familjes dhe marrëdhënieve bashkëshor-

tore. Në përgjithësi, këto njohuri fitohen me anë të përvojës, duke nxjerrë mësim nga jeta. Nganjëherë janë përvojat personale e, nganjëherë ato të miqve tanë, që na japin mësim të vlefshme. Megjithatë, me keqardhje duhet të pranojmë se martesa është diçka që me kalimin e kohës, po e humb vlerën e saj të shenjtë.

Brezat e sotëm, të cilët rriten të llastuar dhe me logjikën e një egoizmi të pakufi, e kërkojnë dashurinë tek marrëdhëniet seksuale dhe parapëlqejnë lidhjet e shkurtra, pa menduar për martesën dhe krijimin e një vatre të ngrohtë familjare.

Tashmë, temat që normalisht duhen menduar të fundit, mendohen të parat dhe martesa shikohet vetëm si një mjet për të përmbushur dëshirat e egos. Ky është një perceptim që mund ta shturë shoqërinë njerëzore.

Ne, njerëzit e përfshirë në jetën e shpejtë të





qyteteve, nuk arritëm të mësonim asgjë nga gjyshet tona, që nuk dinin shkrim as këndim, nga gjyshërit tanë me duar plot kallo, nga ballarët tanë kursimtarë dhe nga nënat tona besnike. Megjithatë, tek ato ne pamë se sa e vështirë është rritja e fëmijëve, se martesë ka nevojë për sakrificë dhe se të gjitha këto shpërblehen nga Allahu (xh.sh.).

\*\*\*

Në një martesë, është shumë e rëndësishme që të dy palët të kenë të njëjtat ndjenja për njeri-tjetrin; sepse dy njerëz, që më përpara nuk e kanë njohur njëri-tjetrin, nuk mund të bashkëjetojnë, pa pasur dashuri në mes tyre.

Martesa është një kontratë, është një dhënie fjale. Ajo është marrëveshja që bëjnë dy njerëz, për të qenë bashkë, si në ditët e bukura ashtu dhe në ato të vështira. Por fatkeqësisht, për rininë e sotme martesë është thjesht përmbushja e disa dëshirave materiale dhe e ndjenjave të përkohshme. Në çastin kur këto dëshira nuk realizohen, martesë e humb joshjen e saj dhe brenda familjes lindin mosmarrëveshje.

Arsyetimi që përdoret më shumë në aktin e divorceve është: "mosmarrëveshje të pazgjidhshme"! Këto fjalë në fakt, fshehin shumë elemente brenda. Nëse do të bënim një shpjegim më të gjerë, mund ta ndajmë në këto pika:

- Mungesë respekti
- Mungesë dashurie
- Mostrajtimi i tjetrit si njeri
- Egoizëm
- Plakja dhe ndryshimi i njeriut
- Pangopësi

Zgjidhja e të gjitha këtyre problemeve, e cila na duket e pamundur, është morali.

Problemet e një martesë që i ka bazat në moral dhe rrugë të cilës vazhdon në po atë drejtim, mund të zgjidhen gjithmonë, pa u kthyer në një sëmundje. Të paktën këta njerëz e kuptojnë përgjegjësinë që kanë, dhe mundohen të gjejnë një rrugëdalje, duke pasur kujdes të drejtat e personit tjetër.

Shprehja "U plakshi bashkë" është një trashëgimi që na ka mbetur nga gjyshërit tanë, ajo përfaqëson idealet që kanë pasur ata për martesën. Në kohët tona, një shprehje e tillë nuk ka më vend. Në ditët e sotme në një martesë kalohen vetëm çaste hidhërimi mes bashkëshortëve. Sot bashkëshortët e hidhëruar me njeri-tjetrin flenë në dhoma të ndara, në pritje të një ilaçi çudibërës, që do të zgjidhë të gjitha problemet që ekzistojnë mes çiftit.

Ne na takon të mbrojmë brezin tonë nga egoizmi dhe nga mosmarrëveshjet e kota dhe martesat nga hidhërimet e panevojshme.



# URTËSI

nga  
Osman Nuri Topbash



## Delikatesa në të folur

*"Ka fjalë që janë të mprehta si shpata, e presin dhe e vrasin miqësinë.*

*Në zemër hapin plagë, që është e pamundur të shërohen. Ndërsa gjelbërimin dhe lulet e dashurisë në kopshtin e shpirtit, i vyshk dhe i vret si stina e vjeshtës.*

*Por ka fjalë që janë si stina e pranverës. Zbukurojnë çdo anë dhe bëhen shkak i paqes dhe i lumturisë."*  
(Mevlana - Xhelaleddin Rumi)

Një padishah, pa në ëndërr sikur po i binin dhëmbët, duke filluar nga të parët deri tek të mbramët. Gjithashtu, pa se nuk mund të hante më asgjë. Atij iu mërzi shpirti nga kjo ëndërr dhe menjëherë thirri interpretuesit e ëndrrave. Pasi u tregoi ëndrrën, padishahu pyeti mjeshtrin e tyre:

- Pa na thuaj njëherë, ç'është kjo ëndërr, mirësi apo fatkeqësi? Çfarë do të thotë?

Pa u menduar fare, mjeshtri iu përgjigj:

- Për fat të keq, është fatkeqësi, o padishah! Do të jetoni gjatë, por do të shihni se si të gjithë të afërmit tuaj do të vdesin një nga një dhe do t'u lënë vetëm.

Ky interpretim bëri që në zemrën e padishahut të fryjnë erëra të ftohta. Pas një çasti qetësie, padishahu ulëriti me egërsi:

- Shpejt!.. Flakeni në burg këtë njeri! Le ta mësojë se çdo të thotë të jesh tellall fatkeqësie!

Rojet e kapën për leckash mjeshtrin dhe e futën në burg. Ndërsa padishahu iu kthye interpretuesve të tjerë dhe u tha:

- Ti! Pa më thuaj, ç'është kjo ëndërr, mirësi apo fatkeqësi?

Ky nuk flet dhe mendon për pak çaste. Papritur i shndrit fytyra dhe fillon të flasë rrjedhshëm:

- Mirësi është, o padishah, mirësi! Kjo ëndërr tregon se do të jetoni më gjatë nga të gjithë të afërmit tuaj dhe do ta drejtoni vendin tuaj në paqe dhe lumturi edhe për shumë vite të tjera.

Padishahu u gëzua shumë me këto fjalë dhe i dha interpretuesit dy qese me flori.

Ndërsa ata që ndoqën ngjarjen që nga fillimi deri në fund, pyesnin të habitur interpretuesin:

- Në fakt edhe ju thatë të njëjtën gjë që tha edhe mjeshtri. Përse padishahu atë e dënoi, ndërsa ty të shpërbleu?

Interpretuesi i ëndrrave buzëqeshi dhe tha:

- Sigurisht që thamë të njëjtën gjë. Mirëpo, ndonjëherë është më e rëndësishme të dish se si ta thuash dhe kujt t'ia thuash, se sa çfarë të thuash.

Kjo ishte një ndodhi mësimdhënëse që tregon ndikimin që kanë fjalët që shprehin të njëjtin kuptim por që ndryshojnë në më-



nyrën e të shprehurit, tek bashkëbiseduesi. Ndërsa, mësimi që duhet të nxjerrim prej kësaj ndodhie, është se gjithmonë duhet të marrim parasysh ndjenjat e bashkëbiseduesit dhe të jemi të kujdesshëm, delikatë dhe të zgjuar kur themi të vërtetën.

Në një ajet fisnik, Allahu Teala i urdhëron robërit e Tij të jenë të ndjeshëm dhe të thonë fjalë të ëmbla e të buta:

***"Thuaju robërve të Mi të flasin atë që është më e mira..."*** (el-Isra, 53)

Ndërsa Profeti i dashur (a.s.), në lidhje me këtë çështje, ka thënë:

*"Allahu Teala, ashtu siç më urdhëroi zbatimin e farzeve, më urdhëroi edhe që të sillem me butësi dhe me mëshirë ndaj njerëzve, duke u thënë fjalë të buta dhe duke mbjellë filiza dashurie në zemrat e tyre."* (Sujuti, el-Xhamiu's-Sagir, I, 59/1695)

Askujt nuk i pëlqejnë fjalët e rënda dhe të pahijshme. Fjala e pahijshme është si një zjarr që ndizet flakë dhe në fund djeg edhe atë që e ka ndezur. Për këtë arsye, duhet t'ua vëmë veshin këtyre fjalëve të Mevlanës së nderuar:

"Kuptoje mirë fjalën e Allahut Teala, kur thotë: ***"O Musa! Foli fjalë të buta faraonit. Tregohu i butë me të!"*** (Ta-Ha, 44) Sepse, nëse i hedh ujë të ftohtë vajit që vlon, do të djegësh edhe furrën edhe tenxheren..."

Përsëri, i nderuari Mevlana tregon në lidhje me ndikimet e ndryshme që kanë tek bashkëbiseduesi mënyrat e përdorimit të fjalëve:

"Ka fjalë që janë të mprehta si shpata. Ato e presin dhe e vrasin miqësinë dhe në zemër

hapin plagë që janë të pamundura të shërohen, ndërsa gjelbërimin dhe lulet e dashurisë në kopshtin e shpirtit i vyshkin dhe i vrasin si stina e vjeshtës. Por ka fjalë që janë të pranverta. Zbukurojnë çdo anë dhe mbjellin kudo paqe dhe lumturi."

Prandaj, besimtari duhet të ketë shumë kujdes në mënyrën e të folurit. Duhet të bëhet burim urtësie që shfaq bukuritë estetike dhe shpirtërore të të vërtetave hyjnore dhe gjithmonë duhet të përdorë një gjuhë të ëmbël, e cila depërton në shpirtat e njerëzve. Ashtu siç urdhërohet edhe në ajetin fisnik, rruga më e shkurtër për të hyrë në zemrat e njerëzve, është butësia dhe mirësjellja:

***"Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje..."*** (Al' Imran, 159)

Këtë moral të lartë të Profetit (a.s.), Ebu Kursafe (r.a.), e shpreh kështu:

Unë, nëna dhe tezza ime shkuam tek Rasullullahu (a.s.). Pasi i dhamë besën dhe u ndamë prej tij, nëna dhe tezza ime më thanë:

-Biri im, nuk kemi parë ndonjëherë si ky njeri! Nuk dimë të ketë njeri tjetër me fytyrë më të bukur, me rroba më të pastra dhe me fjalë më të buta se të tijat. Prej gojës së tij të bekuar sikur gufonte dritë. (Hejthemi, VIII, 279-280)

Ndërsa Ummu Derda (r.anha.), tregon:

"Kur thoshte ndonjë fjalë, Ebu Derda gjithmonë buzëqeshte. Një ditë i thashë:

- Kam frikë se njerëzit do të habiten prej gjendjes tënde!"





Por Ebu Derda ia ktheu:

- Kur Rasulullahu (a.s.), thoshte ndonjë fjalë, gjithmonë buzëqeshte” (Ahmed, V, 198, 199)

Nuk duhet harruar se mënyra e të folurit dhe të shprehurit të një njeriu, është si një pasqyrë, e cila reflekton nivelin e personalitetit, karakterit dhe moralit të tij. Prandaj, një besimtar, ashtu siç shprehet edhe Ebu Bekri (r.a.):

“Duhet të ketë kujdes se çfarë thotë, kujt ia thotë dhe kur e thotë.”

Gjithashtu, duhet t’i vëmë veshin edhe kësaj thënieje të Shejh Sadiut:

“Dy gjëra tregojnë mendjelehtësinë: Heshtja aty ku duhet folur dhe e folura aty ku duhet heshtur!”

Normat e edukatës që duhet të kemi kujdes gjatë të folurit, Kurani Kerim na i sqaron në këtë mënyrë:

Thuaj “قَوْلًا كَرِيمًا / kaulen kerima”, pra fjalë të buta dhe përgëzuese ndaj prindërve dhe mos u thuaj madje as “of”.

Nëse nuk ke diçka për t’u dhënë të varfërve dhe të mjerëve, të paktën thuaju “قَوْلًا مَيْسُورًا / kaulen mejsura”, fjalë dashamirëse të cilat u qetësojnë shpirtin dhe i ngushëllojnë.

Ndaj jetimëve, të cilët kanë nevojë për mbrojtje, ndaj të afërmeve dhe të vetmuarve thuaj “قَوْلًا مَعْرُوفًا / kaulen ma’rufa”, fjalë të mira dhe të bukura.

Edhe për ata që kanë sëmundje në zemrat e tyre, thuaj “قَوْلًا مَعْرُوفًا / kaulen ma’rufa” pa i fajësuar dhe pa u bërë shkas ngatërresash dhe keqkuptimesh.

Ndërsa për të zbutur zemrat e zullumqarëve, thuaj “قَوْلًا نَبِيًّا / kaulen lejina”, fjalë të buta.

Me një fjalë, një besimtar duhet ta edukojë gjuhën e vet me këto norma hyjnore dhe nuk duhet ta harrojë kurrë këtë urdhër të Allahut Teala:

**“... u thoni fjalë të mira njerëzve...”** (el-Bekare, 83)

Allahu Teala na bëftë prej robërve të tij të sinqertë, të cilët çdo mirësi, e konsiderojnë një amanet hyjnor dhe e gjallërojnë atë. Na bëftë prej atyre besimtarëve që, duke u sjellë me butësi, mëshirë dhe duke u folur njerëzve fjalë të ëmbla, bëjnë që në zemrat e tyre të mbijë sythi i Dashurisë Hyjnore ...

Amin!..



# Gdhendie si në mekme

Zabide Topçu

Edukimi i fëmijës është një nga gjërat më të rëndësishme në jetë. Allahu (xh.sh.), ua ka lënë këtë punë, nënës dhe babait. Prandaj karakteri i fëmijës formohet në duart e tyre, janë ata që e lartësojnë ose e humbasin fëmijën. Nëse prindërit i prijnë fëmijës nga e drejta, atëherë edhe ai në atë rrugë do të ecë. Por, në qoftë se nëna dhe babai e lënë pas dore edukimin e fëmijës ose e drejtojnë këtë në rrugë të gabuar, atëherë ata çojnë drejt shkatërrimit veten e tyre dhe fëmijët. Allahu ka thënë:

**“O ju që besoni! Ruajini veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët.”** (Tahrim, 6)

Nga kjo kuptojmë që njeriu, ashtu siç duhet të ruhet nga dënimi i zjarrit, po ashtu duhet të ruajë dhe të mbrojë familjen e tij nga ky dënim.

Nëna dhe babai e kanë për detyrë t’u qëndrojnë pranë fëmijëve. Ata duhet të mundohen që fëmijët e tyre të kenë një moral të lartë dhe të zbatojnë rregullat e fesë. Kur fëmijët falin namaz, prindërit duhet t’u japin shpërblime, në mënyrë që t’i gëzojnë. Po kështu, prindërit duhet të jenë vetë një shembull i mirë për fëmijët e tyre. Një prind shembull, duhet t’i shpjegojë çdo gjë fëmijës së vet... edhe gjërat e thjeshta, edhe ato të vështirat. Mund të marrim si shembull rregullat e ngrënies... Nëse një fëmijë nuk i mëson këto gjëra nga prindërit, nga kush dhe kur do t’i mësojë?

Këtu e shohim të përshtatshme të përmendim disa nga këto rregulla:

*“Ushqimi duhet ngrënë me dorën e djathtë. Duhet thënë bismillah para se të fillojmë të hamë diçka. Gjatë ngrënies nuk duhet të shqetësojmë njerëzit e tjerë duke i shikuar me bisht të syrit. Duhet të shikojmë përpara, të hamë ngadalë dhe ta përtypim mirë ushqimin. Nuk duhet bërë ngut gjatë ngrënies. Nuk duhet folur me gojën plot.*

*Duhet ngrënë me kujdes, pa derdhur ushqimin. Për të kuptuar më mirë se ç’do të thotë varfëri, nganjëherë duhet ngrënë vetëm një ushqim ose duhet të ngopemi vetëm me bukë të thatë. Duhet ngrënë në mënyrë të matur, duke pasur kujdes për të mos ndjerë oreks të tepërt ose lakmi për ushqim. Nuk duhet lënë ushqim në pjatë. Nuk duhet të priremi ndaj disa ushqimeve e jo ndaj disa të tjerave.”*

Siç e përmendëm dhe më përpara, nëse një fëmijë nuk do t’i mësojë këto gjëra nga familja e tij, nga kush dhe kur mund t’i mësojë?

Gjithashtu, është e rëndësishme që prindërit t’i mbajnë fëmijët e tyre larg: gënjeshtreve, ambicies së tepërt, thashethemeve, shpifjeve, egoizmit dhe shumë veseve të tjera të dëmshme. Për t’ia arritur sa më mirë këtij qëllimi, duhen treguar shembuj të ndryshëm sesi këto vese e dëmtojnë njeriun. Në mbrëmje, kur e gjithë familja është në shtëpi, duhet ndarë kohë për fëmijët, duhen pyetur ata se me kë dhe si e kanë kaluar ditën. Prindërit duhet të bisedojnë për çështje të ndryshme me fëmijët. Një kujdes i veçantë duhet treguar për shoqërinë e tyre: është e rëndësishme t’i këshillojmë fëmijët të qëndrojnë me njerëz të mirë.

Këto rreshta dua t’i mbyll me një këshillë të hirësisë Shejh Musa Topbash, i cili në lidhje me këtë çështje ka thënë:

“Gjërat që u mësohen fëmijëve kur janë të vegjël, lënë gjurmë si shenja të bëra mbi gur apo mermer. Ushqeje fëmijën me ushqim hallall, trego kujdes ndaj adhurimeve të tij dhe, në dashtë Zoti, ai do të rritet i mbarë!..”

# Fëmijën nuk e edukojnë vetëm prindërit!..

Aventura e ardhjes së njeriut në këtë botë fillon me prindërit. Fëmija, që për ta është një pjesë e trupit, i kalon vështirësitë e para përsëri nën kujdesin e prindërve. Kështu kapërcen foshnjërinë dhe fëmijërinë.

Nga studimet e bëra del në pah se, që nga shtatzania e deri në kohën e shkollës, fëmijët ndikohen në mënyrë të jashtëzakonshme nga çdo fjalë, veprim apo zakon i prindërve. Pra, që para lindjes, prindërit zënë një vend të rëndësishëm për formimin e fëmijëve. Po më pas?

Ndikimi i prindërve mbi karakterin dhe vetitë (thelbi i vërtetë) e fëmijëve, është krejt i pakët. Ato janë plotësisht *caktim hyjnor*. Një e vërtetë e pamohueshme është fakti se, nganjëherë, nga dijetari ka lindur mizori dhe nga mizori ka lindur dijetari.

Nga ana tjetër, mjedisi shoqëror ku jetojnë prindërit, ambjentet e punës, lagjia ku jetojnë, fqinjët, shokët e punës, kopshti apo vende të tjera si ky, ku fëmija shkon, pak a shumë orientohen nga zgjedhjet e prindërve. Për shembull, familja ka miq apo të afërm, me të cilët prindërit takohen shpesh, ndërsa



me disa të tjerë, të paktën në sy të fëmijëve, takohen më rrallë ose hiç.

Këto zgjedhje e nxisin fëmijën të vizatojë kornizën e mjedisit ku jeton, të tipave dhe zakoneve të njerëzve, shembullin e të cilëve mund ta ndjekë. Në të njëjtën kohë, kur fillon shkolla, zgjedhjet e prindërve përcaktojnë pak a shumë edukimin që do të marrë ai dhe shoqërinë që do të ketë.

Pavarësisht këtyre që thamë, prindërit nuk mund të përcaktojnë çdo person me të cilin fëmija takohet apo nuk mund të kontrollojnë çdo vend ku ai shkon. Në radhë të parë, një gjë e tillë bie ndesh me natyrshmërinë e jetës. Pra, në pikat ku prindërit nuk mund të arrijnë, a duhet që fëmijët të shpërfillen dhe të jenë pa mbrojtje? A është e pamundur të identifikohen shokët e këqinj dhe ambientet e tyre?

Kohë më parë, ngaqë kultura që quhet **"konsumizmi"** nuk kishte ndikuar ende thellë në shoqërinë tonë dhe nuk kishte zënë vend në jetën e përditshme të njerëzve, ekzistonte një kulturë që quhej **"kultura e lagjes"** dhe e **"rrugës"**. Atë kohë, shpeshherë, ndodhte që, edhe pse të gjendur në vende larg prindërve, një fqinj i njohur, një mik apo i afërm, ndërhynte në sjelljet tona dhe mendohej të na mbante larg gabimeve - të paktën ai e ndjente veten përgjegjës për këtë.

Ndoshta kjo gjendje ishte mënyra e pasqyrimit në jetë të motos **"emr-i bi'l-mâruf ve nehy-i ani'l-münker"**, pra të *urdhërosh për të mirë dhe të ndalosh të keqen*. Ne prireshim nga e drejta dhe e mira etikisht përpara fqinjëve apo të afërmeve dhe kjo ndodhte sikur prindërit tanë të ishin në dijeni për çdo gjë. Ky ishte atëherë, pothuajse në funksion: **"një sistem vetëkontrolli shoqëror"**. Për fat të keq, tani në shumë qytete njerëzit janë shpërfillës ndaj çdo gjëje që ndodh jashtë shtëpive të tyre... Mbizotëron një indiferencë, një moskokëçarje...

Po kështu, një histori e rrëfyer na shërben për ilustrimin e kësaj gjendjeje, ku gjatë një gostie, mysafirëve u kishin dhënë lugë me bishta të gjatë për të ngrënë dhe, meqë secili ishte munduar të hante në pjatën e vet, nuk kishin mundur të hanin asgjë përsëmbëri. Pastaj, në të njëjtën sofër kishin ftuar njerëz thellësisht të devotshëm. Këta, duke menduar më shumë vëllain sesa veten, secili i kishte zgjatur lugën atij që kishte përballë dhe kështu ishin ngopur të gjithë.

Ja, njëlloj si në këtë histori, më parë secili kujdesej për fëmijën e tjetrit, si të ishte fëmija i tij: e mbronte atë nga ligësitë, mendohej ta bënte për vete dhe ndikonte pak a shumë edhe në edukimin e tij. Kë-

shtu, fëmijët nuk mësonin vetëm nga prindërit, por edhe nga njerëzit përreth.

Një çështje e ngjashme ishte më parë edhe jetesa në familje me shumë individ. Ndërkohë që prindërit ishin të zënë me punët e përditshme: gjyshi, gjyshja dhe të afërmit kishin mundësi të kalonin më shumë kohë me fëmijët. Kështu, gjatë kohës kur prindërit nuk ishin të pranishëm, ata kishin njerëz të tjerë përreth dhe kalonin orë të këndshme dhe përvoja të larmishme. Në thelb, edukimi i fëmijëve si një detyrë e vështirë, e rëndë dhe e shumanshme ndahej dhe lehtësohej.

Në ditët tona, sado që përgjegjësia e edukimit të fëmijëve bie mbi prindërit, ata nuk mund të ndajnë kohë të mjaftueshme për ta. Jeta moderne shoqërore dhe nevojat e dëshirat e shumta, kanë bërë që prindërit të jenë të dy në punë. Shtojmë këtu edhe dëshirën e njerëzve për të jetuar në luks edhe grykësi, atëherë, fëmijët e mbetur vetëm, më shumë se nga prindërit, ndikohen nga rruga, shoqëria e shkollës, televizioni dhe interneti. Kjo bëhet shkak që pas një kohe, prindërit të mos i njohin më fëmijët e tyre.

Të menduarit e thjeshtë se *"fëmija im nuk ka sjellje të këqija!"* nuk duhet t'i shtyjë prindërit t'i lëshojnë frerët e edukimit të fëmijëve. Me çfarëdo që të mbushet kupa, po me atë do të zbrazet. Çfarëdo që t'i kemi dhënë fëmijës, me to do të përballemi në të ardhmen.

Nëse ne si prindër nuk do të mund t'i rrethojmë dhe t'i mbushim fëmijët tanë me mirësi dhe bukuri, duhet të paktën t'i çojmë ata në ambiente, ku përreth tyre të ketë mirësi. Duhet t'i dërgojmë në shkolla, kopshte, konvikte dhe kurse, ku gjenden njerëz të mirë; duhet ta kontrollojmë shpesh shoqërinë e tyre dhe, si familje, duhet të mbajmë kontakte me njerëz të dobishëm.

Por, ndoshta, siç e thamë edhe më lart, prindërit nuk mund ta realizojnë të vetëm edukimin e fëmijëve, veçse është në dorën e tyre përzgjedhja e kushteve, si shkolla dhe rrethi shoqëror i përshtatshëm për ta.

Si përfundim, mund të themi se duke u interesuar për njerëzit që na rrethojnë dhe fëmijët e tyre, Allahu Teala do të bëjë të mundur interesimin e të tjerëve për fëmijët tanë. Prandaj, duke mos shpërfillur përgjegjësitë për ta, le të mos harrojmë t'i lehdatojmë kokën edhe një fëmije të panjohur që na rastis pranë, sepse të gjithë jemi nga pak përgjegjës për bashkësinë që na rrethon.

# Të drejtat e fëmijëve në Islam

Feja islame është një fe hyjnore, e cila i jep gjithsecilit (hakun) të drejtën e vet. Për më tepër, këto të drejta i barazpeshon në bazë të natyrës, aftësive, nevojave dhe kapaciteteve njerëzore.

Kjo fe, që është shpallur rreth 14-15 shekuj më parë, u ka dhënë fëmijëve, të cilët kanë më shumë nevojë për mbrojtje se çdo pjesë tjetër e popullsisë. Le t'i shohim pra bashkë të drejtat që u ka dhënë feja jonë e bukur fëmijëve, atyre që për nënat dhe për baballarët janë të shtrenjtë si sytë e ballit...

## E drejta e fëmijës për t'u njohur si mirësi e Allahut

Në disa ajete të Kuranit të Madhërishëm theksohet se gjatë periudhës së injorancës (xhahilije),

idhujtarët (mushrikët) mërziteshin aq shumë nga lindja e një vajze, sa u nxiheshin fytyrat. Ndërkohë, është Allahu ai që e jep edhe vajzën edhe djalin. Për më tepër: nuk dihet se cili do të jetë më i dobishëm për familjen, vajza apo djali. Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve selem, asnjëherë nuk ka bërë dallime mes fëmijëve. Për çdo fëmijë të lindur, ai është gëzuar njëlloj dhe të gjithë i ka parë njësoj si mirësi prej Allahut. Për çdo njërin prej tyre ka prerë kurbanin





Akika, ka shtruar gosti dhe ka nxitur sahabët që të sillen kështu.

## E drejta për të jetuar

Islami para së gjithash, përqendrohet te mbrojtja e jetës së fëmijëve dhe e ndalon vrasjen e tyre. Në Kuranin e Madhërishëm thuhet: **"Të humbur janë ata që i vrasin fëmijët e tyre nga**

**mendjelehtësia dhe padija."** (El-En'am, 140) Përsëri, në një ajet tjetër thuhet: **"Mos i vrisni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë! Ne u sigurojmë ushqim atyre dhe juve. Vërtet, vrasja e tyre është gjynah i madh."** (El-Isra, 31)

## E drejta e ushqimit hallall

Elementi më i rëndësishëm për zhvillimin e shpirtit dhe trupit tonë është ushqimi hallall (i lejuar). Kjo është një ndër të drejtat më themelore të fëmijës kundrejt familjes së tij. Për këtë arsye, në hadithin e nderuar thuhet: **"Një nga të drejtat e fëmijës ndaj babait të tij, është dhe ushqyerja me ushqime të pastra (hallall)."**

## E drejta për të pirë qumësht gjiri

Periodha e ushqyerjes me qumësht është periudha më e rëndësishme në lidhje me zhvillimin biologjik dhe psikologjik të fëmijës. Për njeriun, për të fituar cilësitë njerëzore, ushqimi më i rëndësishëm është përsëri qumështi njerëzor. Në Kuranin e madhërishëm theksohet: **"Nënat le t'u japin gjiri fëmijëve të tyre dy vjet, për ata që duan t'ua plotësojnë dhënien e gjirit. Babai i fëmijës ka për detyrë, sipas mundësisë së tij, që t'i sigurojë si duhet ushqim dhe veshmbathje."** (Surja El-Bekare, 233)

Në hadithin e nderuar thuhet: **"Nuk ka gjë më të dobishme për fëmijën se sa qumështi i nënës."**

## E drejta për t'u edukuar, veçanërisht prej grave të fisit të nënës

Kjo temë është shumë e rëndësishme në fenë islame, prandaj duhen marrë masa që para martesës. Pejgamberi ynë ka këshilluar martesën me zonja besimtare dhe të moralshme. Emri i kësaj edukate (përkujdesjeje), që merr fëmija nga nëna (ose nga ajo që luan rolin e nënës) është *hidane*. Ngaqë në këtë moshë fëmija ka më shumë nevojë për përkujdesjen dhe interesimin e grave,



është parë e udhës që më shumë të drejtë në këtë të kenë nëna, gjyshja nga nëna dhe gratë e tjera nga fisi i nënës. Por ka disa kushte që duhet të plotësojë gruaja që do të merret me edukimin e fëmijës. Këto janë: të jetë e lirë, e zgjuar dhe të ketë arritur moshën e pjekurisë. Të sëmurat mendore dhe ato që nuk kanë arritur moshën e pjekurisë, nuk mund ta marrin përsipër këtë detyrë, edhe sikur të jenë vetë nënat e fëmijëve.

Ajo duhet të jetë në gjendje të kujdeset për fëmijën. Problemet si sëmurdja, pleqëria ose fakti që kalon shumicën e kohës jashtë shtëpisë, duke mos pasur mundësi t'i përkushtohet fëmijës, i heqin të drejtën e *hidanes*, për edukimin e fëmijës. Sepse *hidane* përfshin përkujdesjen ndaj fëmijës, edukimin, vëzhgimin dhe mbrojtjen e tij.

Gruaja që do të edukojë fëmijën, duhet të jetë e besueshme. Pra jeta, edukata dhe morali i fëmijës duhet të jenë në duar të sigurta. Për shembull, një grua e njohur për gjynahet (mëkatet) e saj nuk është e përshtatshme në edukimin e fëmijës.

Për fëmijën duhet të kujdeset një prej të afërmeve të nënës. Shkaku i kësaj është se njerëzit e huaj dashje pa dashje e shikojnë pak shtrembër fëmijën. Nuk mund të pritët interesi dhe ngrohësia e nevojshme nga njerëzit e huaj. Mirëpo të afërmit janë ndryshe. Për këtë arsye, Islami, duke ua njohur këtë të drejtë fëmijëve, ka për qëllim t'i ruajë ata nga shtypja, diskriminimi, madje edhe nga shikimet dashakeqe. Pejgamberi ynë ishte shumë i kujdesshëm në këtë temë.

Profetit, pasi kreu Umren, duke dalë prej Medines, i erdhi nga pas vajza e Hz. Hamzait, Umame dhe e thirri: "Xhaxhai im! Xhaxhai im!". Hz. Aliu e



mori për dore dhe i tha Fatimes (r.a.): "Merre pranë vajzën e xhaxhait tënd!". Kur arritën në Medine, mes Hz. Aliut, Zejdit dhe Xhaferit, Zoti qoftë i kënaqur më të gjithë ata, lindi një mosmarrëveshje në lidhje me përkujdesjen ndaj Umames. Hz. Aliu thoshte: "Ajo është vajza e xhaxhait tim!". Xhaferi (r.a.) thoshte: "Ajo është edhe vajza e xhaxhait tim dhe unë jam i martuar me tezen e saj." Ndërsa Zejdi thoshte: "Ajo është vajza e vëllait tim!" (Profeti ynë i nderuar e kishte bërë vëlla Zejdin me Hamzain (r.a.). I Dërguari i Allahut gjykoi që Umame duhej të qëndronte pranë tezes së saj dhe tha: "*Tezja është në vend të nënës.*" (Buhâri, Megâzi 43, Umre 3; Muslim, Xhîhâd, 90)

### E drejta për një emër të bukur

Feja islame ka treguar kujdes të veçantë, jo vetëm ndaj faktit që fëmijës t'i vendoset një emër, por këmbëngul që t'i vendoset edhe një emër i bukur. Pejgamberi ynë (a.s.), këshillon që fëmijës t'i vihet një emër deri në ditën e shtatë të lindjes, ndërsa vetë ai mendohej t'i vinte emrin ditën e parë të lindjes. Në lidhje me rëndësinë e kësaj çështjeje, në një hadith ai urdhëron: "*Të drejtat e fëmijës ndaj babait të tij janë emri dhe edukata e bukur.*" (Sujuti, El-Xhamius-sagir, 2, 538, 2489)

Në një hadith tjetër ka thënë: "*Në ditën e gjykimit ju do të thirreni me emrat tuaj dhe të baballarëve tuaj, prandaj vendosni emra të bukur.*" (Ebu Davud, Edep, 70)

### E drejta për t'u bërë synet

E drejta për t'u bërë synet, e cila theksohet se ka filluar me Hz. Ibrahimin (a.s.), është një prej të drejtave të fëmijëve meshkuj, djemve. Fëmija mund të bëhet synet duke filluar nga java e parë e lindjes,

deri para se të maturohet. Megjithëse të bërit synet nuk është farz, ai është një sunet i fuqishëm dhe gjë e mirë për shëndetin.

### E drejta e lojës

Loja është shumë e rëndësishme për zhvillimin fizik, mendor, madje edhe atë shpirtëror të fëmijës. Të gjithë edukatorët e rinj dhe të vjetër janë të një mendimi për këtë temë. Pejgamberi (a.s.), na ka këshilluar në lidhje me lojërat e fëmijëve, si dhe në lidhje me faktin që duhet të luajmë me ta. Në një hadith ai thotë: "*Kush ka fëmijë, le të bëhet fëmijë bashkë me të!*"

Transmetohet se Profeti (a.s.), i ka zbavitur nipërit e tij duke u nxjerrë gjuhën, duke i lejuar të ecnin nga gjunjët te gjoksi i tij, duke i bartur në shpinë, duke i spërkatur me ujë në fytyrë, duke u tërhequr lehtë flokët ose duke u vendosur emra të llojlojshëm (nofka të mira).

Enesi (r.a.), i cili kujdesej për të Dërguarin e Allahut, e përshkruan atë si "Më i pari i njerëzve për të bërë lojëra me fëmijët (për t'i zbavitur ata)". Kur kalonte në rrugë pranë fëmijëve për të cilët përkujdesej dhe i shihte duke luajtur me bashkëmoshatarët e tyre, ai u jepte selam dhe në lidhje me faktin që luanin mbi dhë, thoshte: "*Dheu, është pranvera e fëmijëve!*"

Ndërsa edukatorë të tjerë të botës islame si Imam Gazaliu, theksojnë që, po të mos u lihet kohë fëmijëve të zbavitën dhe të ngarkohen vazhdimisht me diçka, u vdes zemra dhe u shuhet inteligjenca.

### E drejta për të mos u ndëshkuar para pjekurisë

Sipas fesë islame, fëmija ka të drejtë të mos dënohet deri në moshën e pjekurisë. Fëmija nuk mund të penalizohet si i rrituri. Pejgamberi ynë, në lidhje me këtë ka thënë: "*Janë ngritur lapsat (nuk shkruhen gjynahet) për fëmijën, deri sa të rritet (piqet), për të fjeturin, deri sa të zgjohet dhe për të çmendurin (sëmurin mendor), deri sa të shërohet.*" (Ebu Davud, Hudud, 17)

Dijetarët islamë kanë rënë në konsensus që fëmija të mos rrihet deri në moshën tetë vjeç. Pas moshës tetë vjeç, ata mund të dallojnë të mirën nga e keqja. Pas kësaj moshe, deri në adoleshencë, kur bëjnë ndonjë gabim, fillimisht duhet t'u tërhiqet vëmendja dhe po vazhduan po vazhduan kështu, duhet tu tregohet kufiri.



## E drejta për t'u edukuar mirë

Në një ajet të nderuar thuhet: **“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët.”** (Et-Tahrim, 6)

Pejgamberi (a.s.), thotë: *“Një baba nuk mund t'i lërë fëmijës së tij një trashëgimi më të mirë se edukata e bukur!”*

## E drejta për t'u trajtuar në mënyrë të barabartë

Një temë tjetër në lidhje me edukimin e fëmijëve, për të cilën Profeti ka treguar kujdes, është edhe mosdiskriminimi i tyre. Të bërit dallime mes fëmijëve ai e ka quajtur mizori.

Një ditë, Numan bin Beshir (r.a.), i fali diçka vetëm njërit prej fëmijëve të tij dhe të tjerët i la pa gjë. Ai kërkoi prej Profetit (a.s.) që të ishte dëshmitar i këtij dhurimi. Por Profeti (a.s.), i tha: *“Mos bëj dallime mes fëmijëve! Merre këtë (dhurim) mbrapsht! Mos më bëj mua dëshmitar; unë nuk bëhem dëshmitar i një mizorie! Kjo nuk është e drejtë e unë dëshmoj vetëm për të drejtën!”* (Ebu Davud, Sunen, İxharat, 47; Muslim, Hibat, 10, 14, 19)

Sipas një transmetimi të Ahmed bin Hambelit, Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“Një nga të drejtat e fëmijëve ndaj teje është që t'i trajtosh ata në mënyrë të barabartë.”*

Dijetarët, duke u bazuar në këto hadithe, kanë arritur në përfundimin se prindërit duhet të sillen në mënyrë të barabartë ndaj fëmijëve, duke filluar nga dhurimi e deri te puthja, është kusht që të sillen në mënyrë të barabartë në çdo gjë të dukshme.

## E drejta për të mësuar dijet e detyrueshme fetare

Një baba duhet t'i mësojë fëmijës së tij dije fetare, të paktën aq sa është e nevojshme për të mbrojtur besimin e tij. Në qoftë se nuk mundet ta mësojë vetë, prindi duhet t'ia dorëzojë një mësuesi të besueshëm dhe të përgatitur. Kjo është detyra më e rëndësishme për një baba, i cili mendon për lumturinë e fëmijës në këtë botë dhe në tjetrën.

Në një ajet kuranor thuhet: **“Urdhëroje familjen tënde, që të falë namazin dhe këmbëngul për këtë!”** (Ta Ha, 132)

Siç thuhet në hadithet e mëposhtme:

*“Një e drejtë e fëmijës ndaj babait është mësimi i namazit kur fëmija të aftësohet (për këtë).”*

*“E drejta e fëmijës ndaj babait të tij është mësimi i shkrimit, i notit, hedhjes së shtizes dhe të ushqyerit vetëm me hallall.”*

## E drejta për tu martuar

Sipas një transmetimi të Ebu Hurejrës, Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *“E drejta e fëmijës ndaj babait të tij është që, kur të arrijë moshën e pjekurisë, të martohet.”*

Në një hadith tjetër shpjegohet se, nëse i ka ardhur koha për martesë një të riu, por nuk është martuar, e kjo gjë bëhet shkak që i riu të kryejë ndonjë gjynah, babai i tij mbahet përgjegjës. *“Kush bëhet me fëmijë le t'i japë një edukatë dhe emër të bukur. Kur të arrijë pjekurinë, le ta martojë. Në qoftë se fëmija, pavarësisht se ka arritur moshën e pjekurisë nuk martohet dhe kjo bëhet shkak që të kryejë gjynah, gjynahu është mbi babain e tij.”*

\*\*\*

Le ta përfundojmë shkrimin tonë me një buqetë hadithesh, që theksojnë parimet e të drejtave të fëmijëve në fenë tonë të bukur, Islamit:

*“Dashuria ndaj fëmijëve të ruan nga zjarri. Qerasja bëhet shkak për të kaluar Urën e Siratit. Ngrënia bashkë me ta është garanci shpëtimi nga xhehene-mi.”*

*“Puthni shumë fëmijët tuaj, sepse për çdo puthje do t'u jepet një gradë në xhenet.”*

*“Pranimi i duasë së prindërve për fëmijët e tyre, është si duaja 'seri'ul ixhabe' (pranim i shpejtë) e Pejgamberit për umetin (popullin) e vet.”*

*“Allahu e mëshiroftë babain, i cili e ndihmon fëmijën të kryejë detyrimin e tij si bir/bijë.”*

Zoti na e bëftë të mundur të gjithëve ne, mençurinë dhe forcën për të respektuar të drejtat e të gjithëve. Amin!



# Si Dielli, që ngr

Fëmijët tanë...

Rritja dhe edukimi i fëmijëve është një nga detyrat më të vështira dhe delikate...

Ato janë si lulet... Kanë nevojë për dashuri, durim dhe sakrifica. Çdo lule është e veçantë, e ndryshme nga të tjerat. Disa e duan ujin shumë, disa e duan diellin shumë, disa të tjera rriten në të gjitha kushtet; por të gjithë kanë një të përbashkët: të gjitha lulet rriten me dashuri, zbukurohen nga dashuria. Fëmijët gjithashtu, janë të ndryshëm. Disa janë çapknë, disa janë të qetë, disa janë nevrinë, disa të tjerë janë të dhembshur... Disa fëmijë duan që t'u kushtohet vëmendje, kurse disa të tjerë zemërohen nga kujdesi i tepërt; prandaj duhet të kemi kujdes të sillemi sipas rastit. Dua të ndaj me ju një fjalë që më pëlqen shumë:

"Nëse mendoni për vitin e ardhshëm, mbillni farë; nëse mendoni për dhjetë vjet më vonë, mbillni një fidan. Nëse mendoni për shekujt që do të vijnë, edukoni njerëzit."

Edukimi i njerëzve është puna më e bukur, por edhe më e vështirë! Ky proces fillon që në familje, prandaj prindërit kanë shumë përgjegjësi për edukatën e fëmijëve, në veçanti nënat.

Fëmijët tanë duhet të marrin përkujdesjen që merr një lule. Të gjithë njerëzit, pavarësisht moshës, kanë nevojë për dashuri, prandaj duhet t'i duam pa kushte fëmijët tanë. Duhet të përdorim fjali si: "Unë të dua ty për këtë që je, unë të vlerësoj ty!"

Edukimi i bërë me dashuri, nuk dështon asnjëherë. Njeriu, të cilit i fitojmë dashurinë, bëhet njeriu ynë, njeriu që dëgjon çdo këshillë tonën.

Patjetër që çdo nënë dhe baba dëshiron më të mirën për fëmijën e vet, por nganjëherë ata, pa dashje, i largojnë fëmijët nga vetja. Dashuria ndaj fëmijëve duhet të jetë si dielli, që edhe ndriçon edhe ngroh. Kjo bëhet e mundur në momentin kur ne i vlerësojmë fëmijët tanë.

Ashtu siç lulja drejtohet drejt diellit, ashtu edhe fëmija drejtohet nga njeriu që do. Njeriu që e gjen dashurinë

brenda familjes, nuk ka nevojë ta kërkojë atë diku tjetër. Mes fëmijës dhe prindërve duhet të krijohet një dashuri e tillë, që fëmija të ketë frikë të bëjë gabime që mund ta shuajnë këtë dashuri. Në këtë mënyrë, puna e prindërve bëhet më e lehtë, sepse fëmija diskuton çdo problem me ta dhe merr çdo vendim, duke u bazuar në mendimet e tyre.

Po si mund të arrijmë në këtë shkallë komunikimi? Duhet t'i dëgjojmë fëmijët tanë, duke u munduar t'i kuptojmë, pa i qortuar. Nëse ne i qortojmë, ata do t'ia fshehin gabimin familjes dhe do t'ua tregojnë njerëzve të tjerë. Duhet t'u afrohem në një mënyrë shoqërore dhe t'i këshillojmë, duke përdorur një gjuhë të ëmbël. Duhet shmangur përdorimi i fjalive si:

"Ti je shumë dembel, kokëfortë, i pazoti..."

Kur fëmijës i thuhet: "Zemër, unë të dua fort, por kjo që bëre nuk më pëlqeu.", ai mendon:

"Familja ime nuk dëshiron që unë të bëj gabime, sepse më do shumë."

Sigurisht që detyra jonë e parë është të jemi një shembull i mirë për fëmijët tanë. Fëmijët më shumë mësojnë nga veprimet se nga fjalët tona. Kur kam qenë e vogël, merrja një pe në dorë dhe i thosha nënës sime që po qëndiste:

"Nënë, më mëso edhe mua!"

Unë e shikoja që nëna ime ishte e lumtur kur qëndiste, fytyra e saj e shprehte një gjë të tillë. Nga kjo kuptojmë që, para se të drejtojmë fëmijën tonë drejt qëllimeve të drejta e të bukura, duhet të marrim vetë atë drejtim. Nëse në një familje, sapo dëgjohet ezani të gjithë ngrihen për t'u falur, patjetër që edhe fëmija do të ketë dëshirë ta falë namazin. Ka pasur raste, që kam qenë dëshmitare e fëmijëve shumë të vegjël, që falnin namaz me nënat e tyre. Fëmijët janë pasqyrë e jona. Veçanërisht, në moshë të vogla ata janë në kërkim të shembujve për t'u ndjekur.

Ka rëndësi të tregojmë respekt ndaj mendimeve të fëmijëve, sepse dhe ato kanë rëndësinë e tyre dhe nuk



# oh dhe ndriçon

është e thënë që gjithmonë të kenë të njëjtat mendime me ne. Nuk duhet të sillemi me fëmijët sikur të ishin një pronë e jona, një plaçkë. Duhet t'u japim edhe atyre mundësinë për t'u dhënë përgjigje negative kërkesave tona. Nëse nuk veprojmë në këtë mënyrë, fëmija mësohet të japë vetëm përgjigje pozitive dhe ndihet i detyruar të pranojë çdo gjë (të mirë e të keqe). Madje, edhe në rastet kur u parashtrahet një kërkesë e paarsyeshme, ata mund ta pranojnë.

Një gjë tjetër që ka rëndësi, është edhe respekti që duhet treguar ndaj talentit që ka fëmija. Nëse kjo është një gjë që nuk bie në kundërshtim me rregullat e fesë, pse të mos e ndjekë talentin e tij?

Një ditë shkova te një shoqe. Në shtëpi kishte shumë njerëz. Ne po përgatisnim qerasjet. Pasi përfundova detyrat e mia, fillova t'i tregoja shoqes sime se si t'i rregullonte pecetat në formë trëndafili. Në atë moment, po na vëzhgonte vajza e saj pesëvjeçare. Më pas, ajo kishte hyrë në kuzhinë dhe i kishte rregulluar të gjitha pecetat në formë trëndafili. Madje edhe ia kishte arritur me shumë sukses. Por fatkeqësisht, nëna e saj duke i bërtitur: "Çfarë ke bërë kështu!!!", i kishte hedhur në kosh të gjitha.

Sikur ajo grua t'i kishte marrë pecetat në formë trëndafili dhe t'i kishte vendosur në një pjatancë, fëmija do të kishte menduar që e ëma e do dhe e vlerëson dhe, në këtë mënyrë, vetëbesimi i fëmijës do të ishte rritur.

Nëse dikush do të hidhte në kosh diçka (të bukur ose jo) që ju keni bërë me duart tuaja, a nuk do të mërzhiteshit? Ne duhet të jemi të ndjeshëm, duhet të vendosim veten në vendin e fëmijëve.

Nuk duhet të lëmë pas dore inkurajimin e fëmijëve, duhet t'i përmendim shpesh anët e tyre të mira, në mënyrë që ta zhvillojnë veten në ato drejtime. Nëse i thua 40 herë një njeriu, që është budalla, ai bëhet me të vërtetë i tillë, sepse e pranon atë cilësim. Prandaj, kur flasim me fëmijët tanë, duhet të përdorim fraza pozitive, epitete të bukura. Nganjëherë, fjalët tona pranohen si *dua*. Kështu vepron një e njohura ime, e

cila, kur nervozohet me fëmijët e saj shumë çapkënë, u drejtohet atyre me këto fjalë :

"*Allahu ju sjellte të mira!*", dhe është e vërtetë që Allahu gjithmonë u ka sjellë të mira.

Ndaj fëmijëve tanë duhet të jemi të mëshirshëm. Nuk po them që t'u plotësojmë çdo tekë të tyre apo t'u sjellim të gjitha të mirat e kësaj bote para këmbëve!... Ne duhet t'u tregojmë atyre se në këtë botë ka disa gjëra të vështira për t'u arritur, por në të njëjtën kohë, duhet t'u tregojmë edhe mënyrat për të mposhtur pengesat. Ashtu siç hekuri farkëtohet duke u rrahur, edhe njeriu kalitet nga vështirësitë. Fëmijëve tanë u duhet treguar, që çdo vështirësi kalohet, kur ekziston mbështetja tek Allahu (xh.sh.); në këtë mënyrë i mësojmë ata t'i luten Zotit dhe të kërkojnë ndihmë prej Tij. Fëmijët duhen rritur sipas mënyrave që parashtron feja islame: punëtorë, të sinqertë dhe me moral të pastër. Ata duhet të kuptojnë se çdo genie do të ketë fundin e saj, prandaj duhet të jemi falënderues... Nëse veprojmë në këtë mënyrë, fëmijët tanë do të rriten në rrugë të drejtë.

Gabimi më i madh, që mund të bëjë një nënë, është të mos e zgjojë në mëngjes fëmijën e vet për të falur namazin e sabahut nga dhembshuria që ka për të. Mos vallë ajo nënë dëshiron të shikojë fëmijën e saj të digjet në zjarr...!? Nëse fëmija bën veprime që janë në kundërshtim me fenë e Allahut, ajo duhet ta qortojë dhe, nëse nuk ndërron qëndrim, duhet t'i zemërohet.

Gjëja më e rëndësishme për fëmijët tanë është morali i tyre. Ne duhet t'i edukojmë ata me edukatën islame. Duhet t'u mësojmë fëmijëve tanë arsyen që na ka sjellë në këtë botë dhe cili duhet të jetë qëllimi ynë në jetë. Fëmija që jeton në përputhje me rregullat e Zotit, është i lumtur në këtë botë dhe në botën e përtejme.

Në kohët e sotme është shumë e vështirë të rrisësh një fëmijë, por ne duhet të përpiqemi me aq sa mundemi dhe t'i bëjmë *dua* Allahut, për të na ndihmuar.

O Allah! Mos na sprovo ne me fëmijët tanë...! Na dhuro fëmijë të mirë dhe të devotshëm!.. Na e bëj të mundur të rrisim fëmijë me moral të lartë! Amin!

# AJO QË FITOHET NGA I ZOTI I SHTËPISË, I MJAFTON FAMILJES

Sipas studimeve të bëra kohët e fundit, arsyeja kryesore që shkakton ndarjen e çifteve janë mosmarrëveshjet mes tyre. Pas kësaj, arsyet e tjera vijojnë si më poshtë: mungesa e vëmendjes, mungesa e përgjegjësisë, xhelozia, grindjet që lindin nga fëmijët, problemet financiare dhe mospajtimet mes bashkëshortëve.

Përsëri sipas një studimi, 90% e njerëzve të divorcuar jetojnë në qytete. Një fakt tjetër është që pjesa më e madhe e çifteve që ndahen, kalojnë vetëm 2 deri në 5 vjet martesë. Pjesa më e madhe e këtyre çifteve vendosin të martohen vetë, pasi kanë rënë në dashuri dhe pas një periudhe flirtimi. Vihet re që, në përgjithësi, kërkesa për ndarje bëhet nga gratë...

Barazia gjinore, e cila propagandohet e zbukuruar nga media, e dëmton gruan. Gruaja e ka të vështirë të qëndrojë mbi këmbët e saj në një jetë të mbushur me vështirësi. Kjo përpjekje e stërmunduar e saj u hap rrugë shumë veseve të këqija si mosbindjes, mosmarrëveshjeve dhe grindjeve të shumta.

Një mënyrë që përdor media për të shpalosur idetë e saj janë edhe telenovelat... Çdo telenovelë mundohet të formojë një mënyrë jetese të vetën. Një telenovela ka formë komedie, një tjetër tregon për njerëz që merren me mafia, kurse një tjetër ka një temë dramatike; por asnjëra prej tyre nuk ka tema familjare. Të gjitha këto janë programe në të cilat njerëzit godasin njëri-tjetrin pas shpine ose janë të zhytur në një jetë të rehatshme luksi... Duhet të na tërheqë vëmendjen fakti se pjesa më e madhe e shikuesve të këtyre telenovelave, janë njerëz me edukatë jo të mirëformuar dhe nuk janë praktikantë në fenë e tyre... Sikur kaq të mos mjaftonte, në programe të ndryshme, bëhen diskutime dhe komentime, që kanë të bëjnë me këto telenovela... E gjitha

kjo imponon një mënyrë jetese në ndërgjegjen e secilit prej nesh... Në këtë mënyrë, media, ndikon në ndryshimin e karakterit të të gjithë shikuesve.

I gjithë ky ndryshim nuk merr aspak kohë për t'u realizuar. Njerëzit fillojnë të imitojnë mënyrën e jetesës, mënyrën e të folurit të aktorëve që shikojnë në telenovela dhe, duke e bërë këtë, lënë mbas dore traditat familjare, të cilat janë të kundërta me jetën e telenovelave. Në këtë mënyrë, fillon hapi i parë i prishjes së familjeve. Kështu, fillojnë të marrin jetë sjellje të tipit: "Unë nuk kam pse të duroj askënd, unë mund të qëndroj në këmbët e mia!" dhe lind një jetë me qendër vetveten. Të gjitha këto ndiqen me largimin nga feja dhe prishjen e familjeve. Të gjitha mendimet pozitive, që ndërtojnë një familje, zhduken.

Më përpara kishte familje të përbëra nga gjyshe, gjyshër, nëna, baballarë, fëmijë dhe nipa, të cilët jetonin në të njëjtën shtëpi. Në familje gjithmonë dëgjohej fjala e gjyshit, vlerësohej prania e gjyshes, pjesëtarët e familjes i diskutonin problemet me njëri-tjetrin. Kushtet e sotme zvogëluan edhe përmasat e familjeve. Fëmijët tashmë nuk jetojnë me ngrohtësinë e gjyshave dhe nuk marrin mësim nga përvoja e prindërve. Mungesa e njerëzve më të mëdhenj në familje i hapi rrugë prishjes së karakterit të njerëzve.

Të moshuarit tanë thonë: *ajo që fitohet nga i zoti i shtëpisë, i mjafton familjes*; Zoti e shton dhe e bën të mundur jetesën e familjes, pa probleme. Nga kjo kuptojmë që, kur burri i shtëpisë mundohet të punojë dhe të fitojë nga punë të lejuara, Allahu e shton begatinë e fitimit të tij dhe bën që t'u mjaftojë të gjithë pjesëtarëve të familjes.





Kriza ekonomike është zjarri që ndezi fitilin e gjithë këtij ndryshimi që po ndodh në familje... Familje që ndodhen në kushte të vështira financiare, mundohen të gjejnë mënyra të ndryshme për të shpëtuar prej saj. Duke u përpjekur për të mbrojtur anën financiare të familjes, nuk e kuptojnë që po çojnë dëm anën morale të saj. Disa nuk ishin të përgatitur për të kaluar në një nivel tjetër shoqëror, disa të tjerë u nisën drejt qyteteve të mëdha për të kërkuar fatin, disa fëmijë u larguan nga familja dhe u bënë pre e ambicieve të tepruara.

Dua t'ju tregoj për një grua, që është nëna e një shoqes së mbesës sime... Ajo është një grua që ka kryer vetëm shkollën filllore dhe që vjen nga shtresat e mesme. Vitet e fundit kishte pasur fatin t'i rritej mirëqenia, duke qenë se punët e të shoqit po ecnin mirë. Kishin marrë makinë të re, shtëpi të re... ishin njohur me njerëz të rinj... Me të gjitha këto, kishte lindur dhe ishte shtuar interesi për gjërat e kësaj bote dhe dëshira për t'u dukur mirë para njerëzve. Ftesat ishin shtuar aq shumë, sa kishte filluar të përdorte axhendë për të shënuar oraret e shumta. Çdo ftesë ishte një shqetësim më vete. Për secilën ftesë duheshin bërë shpenzime të pafundme. Gruas që merrej me të gjitha këto gjëra, burri i kishte thënë që mund të bënte çfarë të donte, me kusht që t'ia plotësonte atij dëshirat. Kjo gjendje kishte filluar ta shkatërronte pak nga pak familjen. Nga ana tjetër, bashkë me kalimin në një lloj tjetër shoqërie, kishin lindur edhe ndryshime në mënyrat e veshjes. Dalëngadalë, ishin shkurtuar palltot dhe fustanet... Kur punët e të shoqit kishin filluar të përkeqësoheshin, familja e kishte paguar shumë shtrenjtë këtë jetesë luksoze.

Fatkeqësisht, faturën më të madhe e paguanë fëmijët, por kjo nuk është shumë e dukshme. Prindërit bëjnë përpjekje të mëdha për t'u krijuar kushte të mira ekonomike, por harrojnë të merren me edukatën e tyre. Punët me orë të zgjatura u krijojnë kushte fëmijëve të kalojnë orë të tëra para televizorit, internetit apo në rrugë. Në mbrëmje prindërit, tashmë të lodhur, mjaftohen me interesimin për nevojat materiale të fëmijëve të tyre. Fëmija tashmë është i lirë t'i shpenzojë sipas dëshirës paratë që i jepën nga prindi. Në këtë mënyrë, formohet një familje e përbërë nga njerëz, që jetojnë në të njëjtën çati, por që nuk e njohin më njeri-tjetrin.

Çfarë duhet bërë?

Prindërit duhet të rezervojnë më shumë kohë për vete dhe për fëmijët e tyre. Ata duhet të përpiqen të kuptojnë shqetësimet dhe dëshirat e fëmijëve. Kërkesat shpirtërore janë më të rëndësishme se kërkesat materiale. Prindërit duhet të kujdesen për moralin e fëmijëve, duhet t'i ndihmojnë ata të afrohen me fenë dhe duhet të krijojnë një mjedis të qetë e të mirëkuptueshëm, brenda familjes.

Koha është pasuria më e vyer e njeriut, prandaj le ta vlerësojmë atë siç duhet. Ta mbushim kohën tonë me gjëra të vlefshme për familjen tonë dhe shoqërinë në të cilën jetojmë. Duke marrë parasysh këtë këshillë, kuptojmë që edhe gratë duhet të jenë më aktive.

Gratë dhe burrat duhet ta kuptojnë rëndësinë e familjes dhe ta mbrojnë atë, duke treguar durim dhe duke bërë sakrificë për njeri-tjetrin. Streha familjare është ai vend që të jep më shumë qetësi se çdo vend tjetër, pavarësisht çdo problemi apo vështirësie që mund të hasim gjatë jetës.



# Ushqyerja në periudhën E FËMIJËRISË

Ushqyerja e shëndetshme në periudhën e fëmijërisë është marrja në mënyrë të ekuilibruar e të gjitha ushqimeve të nevojshme për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës. Të ushqyerit në mënyrë të ekuilibruar, do të thotë të marrësh në mënyrë të rregullt grupet kryesore të ushqimeve, si: mishi, veza, peshku, frutat dhe perimet.

Ushqyerja, ndikon si në zhvillimin fizik, po ashtu edhe në zhvillimin shpirtëror të fëmijës. Ajo do të sigurojë një jetë të shëndetshme gjatë fëmijërisë dhe adoleshencës.

Shpejtësia e rritjes dhe nevoja për energji të fëmijët ndryshon në bazë të moshës. Rritja dhe zhvillimi më i shpejtë ndodh gjatë dy viteve të para të jetës.

Viti i parë është periudha e fëmijërisë së qumështit (*foshnjërisë*). Veçanërisht gjashtë muajt e parë, ushqyerja me qumështin e nënës është shumë e rëndësishme. Pas 4-6 muajsh, në mënyrë që fëmija të mësojë për typjen dhe gjëllitjen, duhet të fillohet t'i jepet, dalëngadalë, pure, pastaj pure me copa ushqimesh. Tashmë, Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) këshillon që ushqyerja me qumështin e nënës të vazhdojë gjatë dy viteve të para të jetës, megjithëse pas moshës një vjeç, fëmija mund të hajë ushqimet e tryezës, bashkë me të rriturit.

Është e vërtetë që ushqyerja në mënyrë të shëndetshme gjatë dy viteve të para të jetës do të ndikojë pozitivisht në jetën e fëmijës, në vazhdim. Pas moshës një vjeç, fëmija është më i pavarur. Për këtë arsye, nga njëra anë duhet ta inkurajojmë të hajë vetë dhe nga ana tjetër, duhet të sigurohemi që të marrë në sasi të duhur ushqimet e nevojshme.

## Ushqimi te bebet 0-6 muajsh

Në këtë periudhë ushqyerja ideale është ushqyerja vetëm me qumështin e nënës. Kësaj i thuhet "ushqyerje natyrore".

Në rastet kur nuk është e mundur ushqyerja me qumështin e nënës, mund të përdoren ushqimet e gatshme për fëmijë. Këto ushqime janë produkte të prodhuara nga qumështi i lopëve, por që janë përpunuar, në mënyrë që përbërja e tyre të ngjajë me përbërjen e qumështit të nënës. Ushqyerja vetëm me ushqime për fëmijë quhet "ushqyerje artificiale" ose "ushqyerje me biberon".

Brenda gjashtë muajve të parë, në qoftë se fëmijë i jepet edhe qumështi i nënës, edhe ushqime të gatshme, kjo quhet "ushqyerje e përzier". Nganjëherë, duke menduar se qumështi i nënës nuk i mjafton fëmijës ose që fëmija nuk ngopet, fillojnë t'i japin ushqime të gatshme, çka është në shumicën e rasteve, e gabuar. Në këto raste edhe pakësohet qumështi i nënës, edhe fëmija rrezikon të përballet me "ushqyerjen artificiale". Ndërsa kjo i hap rrugën një sërë problemesh shëndetësore.

## Ushqyerja natyrore dhe ushqimi i mrekullueshëm: qumështi i nënës

Duke filluar nga lindja, deri gjashtë muaj pas lindjes, ushqyerja e fëmijëve vetëm me qumështin e nënës, pa i dhënë asnjë ushqim shtesë, përfshirë dhe ujin, quhet "ushqyerje natyrore".

Qumështi i nënës është i pastër, gjithmonë në nxehtësi të përshtatshme, ekonomik dhe nuk ka probleme përgatitjeje. Qumështi i nënës forcon lidhjen emocionale mes nënës dhe fëmijës. Gjatë ushqyerjes me gj, nëna ushqen jo vetëm trupin, por edhe shpirtin e fëmijës. Fëmija përshtatet me mjedisin e jashtëm, në sajë të qumështit të nënës. Gjatë ushqyerjes me gj, fëmija është shumë afër nënës dhe e ndjen veten njësh me të. Momenti i gjidhënies është momenti, kur ndihet më fuqishëm ndjenja e besimit dhe e dashurisë, si dhe ngrohtësia e nënës. Të gjithë fëmijëve u pëlqen të përqafohen. Në studimet e bëra është vënë re se te fëmijët që nuk përqafohen, është më i lartë rreziku i vdekjes së me-



njëherëshme. Pavarësisht moshës së fëmijës, nuk ka pozicion më të rehatshëm për fëmijën se pozicioni i gjdhënies. Gjdhënia është shumë e rëndësishme për zhvillimin shpirtëror të fëmijës. Problemet sociale, si për shembull varësia ndaj alkoolit, vërehen më pak te fëmijët që kanë pirë qumështin e nënës. Qumështi i nënës siguron zhvillimin e fëmijës si një person i shëndetshëm nga ana shpirtërore.

Qumështi i çdo nëne është i veçantë për fëmijën e saj dhe ditë pas dite, bile edhe brenda ditës mund të ndryshojë përbërje. Qumështi i nënës që lind

para kohe, është i përshtatshëm për fëmijën e para-kohshëm, qumështi i nënës që lind në kohë, është përsëri i përshtatshëm për fëmijën e saj.

Sasia dhe cilësia e qumështit, që vjen ditët e para, është e ndryshme me sasinë dhe cilësinë e qumështit që vjen në ditët më pas. Qumështi i natës është i ndryshëm nga qumështi i ditës dhe qumështi që vjen në fillim të gjdhënies, është i ndryshëm nga ai në fund të saj.

A ka ndonjë sistem teknik, përmes së cilit të prodhohet një qumësht i cili të dijë se sa muajsh do të

lindë fëmija, që të llogarisë ditën dhe javën e barrës, që të përcaktojë fillimin dhe fundin e gjdhënies, që të përcaktojë nëse është ditë apo natë, që të dijë strukturën e stomakut dhe zorrëve të fëmijës apo të prodhojë proteina, të cilat mund ta mbrojnë fëmijën nga mikrobet e botës së jashtme? Apo mos vallë mund ta prodhojë këtë qumësht nëna, e cila është e rraskapitur pas 40 javësh të lodhshme barre e, për më tepër, pas lindjes?

Këto janë ngjarje të mrekullueshme (muxhize), për të cilat nuk ka informacion as nëna dhe në asnjë mënyrë nëna nuk është e përfshirë në to. Për shkak

se qumështi i nënës nuk ka një strukturë (përbërje) standarde, pavarësisht studimeve intensive, është kuptuar që nuk mund të nxirret plotësisht formula e qumështit.

Nuk është zbuluar asnjë makineri, e cila mund të prodhojë këtë ushqim të pashoq, si qumështi i nënës dhe as nuk do të zbulohet. Duke parë vetëm qumështin e nënës, është e mundur të vërehet se sa i përkryer (i pa të meta) është krijuar njeriu. Sigurisht, kjo është e mundur për sytë që shohin dhe të zotët e mendjes, që arrijnë të kuptojnë...





# Baklavaja

Baklavaja është një ëmbëlsirë turke, së cilës i kanë dalë për zot shumë krahina dhe e quajnë të tyren. Historia e saj arrin deri tek asirianët e lashtë. Ajo bëhet duke vendosur mes petave të holla, sipas krahinave, arra, stika, lajthi...etj.

Sipas shijes së sherbetit dhe ictim, përmenden lloje të ndryshme baklavashë. Me rastin e ditëve të veçanta, të ftesave për iftare ose të bajrameve, na kap një telash i ëmbël. Në fakt, nuk është dhe shumë e vështirë të bësh baklava. Këtë mund ta vëreni, në qoftë se e praktikoni recetën shkallë- shkallë. Tani le të kalojmë te receta:

## PËRBËRËSIT PËR BRUMIN

2 vezë  
Miell për baklava  
2 lugë uthull  
Pak kripë  
1 gotë uji qumësht i ngrohtë  
Maja  
Një gotë çaji gjalpë i shkrirë  
Pak niseshte

## IÇI

Arra, lajthi ose stika  
250 gramë gjalpë i shkrirë

## PËR SHERBETIN

5 gota uji sheqer  
3.5 gota uji ujë  
Gjysmë limoni

Në enën ku do të përgatisim brumin hedhim vezët, qumështin, gjalpin, uthullën dhe kripën dhe i rrahim. U hedhim miell dhe e mbrujmë, deri sa të bëhet një brumë i ngjeshur. Brumi ndahet në copa në madhësinë e një arre dhe lihet të pushojë.

Më vonë, fillojmë t'i hapim me okllai, duke përdorur nisheste dhe i hapim deri në madhësinë e një pjate gjelle. Duke vendosur nisheste mes tyre, vendosim 16-18 peta një mbi një. (Sipas dëshirës mund të bëhen dhe nga një dhjetëshe peta bashkë.) Në këtë mënyrë, përftohen tre grupe prej 16 petash.

Tepsia lyhet me gjalpë. Merret një grup 16 petësh dhe hapet në gjerësinë e tepsisë. E shtrojmë në tepsia dhe sipër i hedhim gjysmën e arrave. Hapet dhe grupi i dytë dhe sipër i hedhim arrat e mbetura. Së fundi, hapet dhe grupi i tretë dhe e vendosim sipër. Baklavaja pritët në formën e saj karakteristike. Pastaj sipër i hedhim gjalpin e nxehtë, në mënyrë që të përhapet në çdo anë. E pjekim në furrë në 200 gradë, deri sa të skuqet përsipër.



Ndërkohë që bakllavaja piqet, vendosim në një tenxhere sheqer, ujë dhe lëkurë limoni të grirë dhe për 15-20 minuta e ziejmë deri sa të marrë trajtën e ajkës.

Pasi piqet, bakllavaja nxirret nga furra dhe lihet të ftohet. (Sipas dëshirës, për një sipërfaqe sa më të shndritshme mund ta lyejmë sipërfaqen e bakllavës me yndyrë). Në këtë moment i hidhet sherbeti i nxehtë. Bakllavaja duhet të serviret pasi ta thithë mirë sherbetin.

**Shënim: Petat mund të hapen dhe një nga një. Hapja një nga një ia shton bukurinë dhe shijen.**

## *Këshillat për një bakllavë të lezetshme:*

-Mënyra e parë për të pasur sukses në bërjen e një bakllavaje të mirë është përdorimi i produkteve të freskëta dhe cilësore. Veçanërisht, mielli duhet të jetë miell bakllavaje i klasit të parë.

-Sa më e hollë që të hollohet peta, aq më e mirë vjen në gojë bakllavaja.

-Sasia e nishestesë duhet të rregullohet mirë, nishesteja e tepërt e than brumin.

-Vezët e tepërta vështirësojnë hapjen e brumit.

-Gjatë pjekjes duhet të kemi kujdes nxehtësinë, sepse bakllavaja nuk duhet tharë shumë.

-Brumi nuk duhet zënë shumë i fortë.

-Sherbeti duhet të jetë më viskoz (i trashë) se i ëmbëlsirave tjera.

-Në qoftë se gjatë pjekjes kapaku i furrës hapet herë pas here, do të kemi qarkullim të ajrit, çka do të sigurojë pjekjen e pjesës së brendshme të brumit.

-Sherbeti duhet të jetë i nxehtë dhe bakllavaja e ftohtë.

-Bakllavanë mund ta ruajmë për një kohë pa ia hedhur sherbetin. Kur të duam t'ia hedhim sherbetin, mund ta ngrohim pak në furrë, në mënyrë që bakllavaja ta thithë më mirë atë.



şimşek®

Hayatın Tatlı Yanı...





# Molfix

A e dini pse është  
kaq i lumtur  
ky fëmijë?



Sepse fëmijët e lumtur përdorin **Molfix**

**tema**  
Trade Company

Adresa: Rr. Turgut Ozal Nr. 8, Prizren / KOSOVË - Tel & Fax: +381 (0) 29 230 951  
Mob: +377 (0) 44 140 286 / +386 (0) 49 140 286 - e-mail: omermacun@hotmail.com

NEW



**Papia**

NEW



**Molped**

Prodhimet me të cilat kemi fituar SHPËRBLIMIN KOSOVAR TË PRODUKTIT TË QUMËSHITIT 2005



KONSUMONI PRODUKTE ME CILËSI TË VËRTETUAR



# CILËSI E VËRTETUAR



Jogurtat me përmbajtje të kulturave *Bio Active*  
Në Kosovë prodhohet vetëm nga qumështorja "ABI"

Probiotic  
drink



[www.abimilk.com](http://www.abimilk.com)

Industria e qumështit "ABI" Prizren-Kosovë

Industria e qumështit "ABI" Prizren-Kosovë

Adresa-Address: "Tirana" N:9, Prizren  
Tel & Fax: +381 29 622 356  
E-mail: [abi@abimilk.com](mailto:abi@abimilk.com)

[www.abimilk.com](http://www.abimilk.com)

"ABI" është licensuar nga ana e Agjencisë Veterinare e Ushqimit të Kosovës

Numri i licencës : AVUK-001

"ABI" ka fituar të drejtën për eksport me numrin eksportues : KS-033